



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë e Zbatuar”

Kolegji Universitar “Logos”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Asoc. Edlira Martiri

Dr. Alketa Grepcka

Maj / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Informatikë e Zbatuar”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “LOGOS”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Informatikë e Zbatuar
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.1055 date 29.07.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 15, datë 01.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim i BA nr.49 date 05.07.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE / 10 PAK
18	Numri i studentëve:	- 2019-2020; 15 studentë; - 2020-2021; 15 studentë; - 2021-2022; 17 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Logos" është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron një larmi programe studimi. Në vitin 2009 Instituti i Formimit Profesional "Frymë Dashurie" u shndërrua në Shkollën e Lartë Private "Logos" përmes VKM-së nr. 1055 datë 29.07.2009 në përbërje të së cilës kishte dy fakultete: Fakulteti i Shkencave të Aplikuara që ofronte edhe programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë të Zbatuar dhe Fakultetin Ekonomik. Me anë të Vendimit të Këshillit të Akreditimit nr.338 datë 8.6.2012, të shpallur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.282 datë 04.07.2012 u akreditua programi i ciklit të parë Bachelor "Informatikë e Zbatuar".

Pas miratimit të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" "LOGOS" u njoh si Kolegj Universitar jo fitimprurës me dy Fakultete:

- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara me dy departamente: Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore dhe Informatikë e Zbatuar dhe një Qendër e Kërkimit;
- Fakulteti Ekonomik i përbërë nga tre departamente përkatësisht: Financë dhe Kontabilitet, Menaxhim Biznesi dhe Menaxhim Turizmi;

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Zbatuar" lëshon diplomë universitare Bachelor në "Informatikë e Zbatuar". Diploma është regjistruar përmes urdhërit nr.15 datë 01.03.2022. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës, njësi përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara.

Programi i studimit Bachelor në "Informatikë e Zbatuar" ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit Europian të transferimit të krediteve në 180 kredite ECTS. Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Zbatuar" është puna për të siguruar bashkëpunim me operatorët e tregut për ofrimin e produkteve (zhvillim software & hardware, administrim sistemi, konfigurim dhe menaxhim rrjeti, zhvillim dhe mirëmbajtje databaze) të aplikueshme në fushat përkatëse me qëllim zbatimin dhe përfitimin në praktikë. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e Kolegjit Universitar "Logos".

KU Logos ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Zbatuar" më datë 29.10.2021. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin për herë të dytë të këtij programi studimi.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Akreditimi i programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Zbatuar" është realizuar sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.49 datë 05.07.2019, i cili është shoqëruar edhe me disa rekomandime si më poshte vijon:

1. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik, me grada dhe tituj, me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70% dhe uljen e ngarkesës së lartë mësimore të stafit akademik efektiv aktual të angazhuar në këtë program studimi;
2. Institucioni, të rishikojë ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese nga A në E, duke siguruar përputhshmërinë me parashikimet në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për Elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
3. Institucioni, të rishikojë planin mësimor me qëllim përfshirjen e praktikës profesionale si element i detyrueshëm kurrikular.
4. Institucioni, të realizojë një studim të mirefilltë të tregut të punës për këtë program studimi;
5. Institucioni, të kryejë një analizë të punësimit të studentëve të këtij programi studimi dhe të shtojë përpjekjet për rritjen e bashkëpunimit me kompani që veprojnë në sektorin e TIK, për të ndihmuar në punësimin e studentëve;
6. Institucioni, të vijojë me pasurimin dhe përditësimin e bibliotekës me tituj në fushën e TIK.

Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Rekomandimi 1: “Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik, me grada dhe tituj, me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70% dhe uljen e ngarkesës së lartë mësimore të stafit akademik efektiv aktual të angazhuar në këtë program studimi”.

Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës ka në përbërjen e tij staf akademik efektiv (5 PAE) dhe staf akademik me kohë të pjesshme (6 PAK).

Tabela: Stafi akademik i angazhuar për programin e studimit Bachelor në “Informatikë e Zbatuar”

Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	1	1	1	1	1	1
Prof.As.Dr	0	3	0	1	0	1
Dr/PhD	1	2	1	3	0	4
Msc	4	4	3	3	5	1
Në total	6	10	5	8	6	7

- Për shkak të numrit të ulët të studentëve, KU “LOGOS” ka marrë miratimin e MASR, dhe është pranuar që numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë për departamentet të jetë 5, nga të cilët dy prej tyre të kenë gradë apo titull shkencor dhe se personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë, për çdo rast, jo më pak se 70% të ngarkesës. (*Aneks 41.11 Marreveshje MAS, Reduktimi i numrit të personelit akademik në njesinë baze*)

- Institucioni ka reflektuar për të ulur ngarkesën mësimore të stafit akademik efektiv bazuar edhe në plan veprimin për përmbushjen e rekomandimit të dhënë nga Bordi i Akreditimit. Gjatë vitit akademik 2019-2020 konstatojmë një mbingarkesë të stafit akademik me gradën shkencore Dr në proces dhe MSc. Ndonëse ngarkesa mësimore është brenda normës së përcaktuar nga korniza ligjore, numri i lëndëve që mbulohej është i madh. Shembull japim për tre pedagogët me gradën MSc të cilat mbulojnë secila 5 lëndë në programin e studimit, pedagogu me gradën Dr në proces e cila mbulon 6 lëndë duke sjelle edhe një mbingarkesë në përgatitjen profesionale dhe kufizuar hapësirën kohore për punën e tyre në drejtim të aftësimit shkencor. Per vitin akademik 2020 – 2021 dhe 2021 – 2022 si pasojë e rekrutimit të një pedagogu me gradën shkencore Dr ngarkesa mësimore është shpërndarë më drejt. GVJ evidenton një reduktim të numrit të lëndëve që pedagogët me gradën MSc mbulojnë (per stafin me gradën MSc ngarkesa është reduktuar në 3 deri në 4 lëndë ndërsa për stafin akademik me gradën Dr. në proces është reduktuar në 4 lëndë).
- GVJ konstaton një rritje të stafit PAK përgjatë periudhës 2020-2022 duke sjellë edhe një rritje të cilësisë së mësimdhënies.

Nga evidentimi i bërë për ngarkesën mësimore, konstatohet:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2019-2020	1800	1080	720	60% /40%
2020-2021	1680	885	795	53% /47%
2021-2022	1770	945	825	53% /47%

Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe të Departamentit të Informatikës së Zbatuar & Statistikës ku synohet në hapjen e një masteri profesional, *GVJ sugjeron rritjen e stafit akademik efektiv e cila do të sjelle lehtësimin e punës shkencore të stafit në drejtim të plotësimit të objektivit të tyre me grada shkencore dhe forcimin e kapaciteteve për përmbushjen e objektivave aftëgjatë të njësisë bazë. GVJ konstaton përmbushjen “plotësisht” të rekomandimit;*

Rekomandimi 2: *“Institucioni, të rishikojë ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese nga A në E, duke siguruar përputhshmërinë me parashikimet në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për Elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë””*.

IAL ka bërë rishpërndarjen e lëndëve, si dhe ka arritur të ruajë raportet e shpërndarjes së lëndëve sipas kategorive formuese A-E. *GVJ konstaton përmbushjen “plotësisht” të rekomandimit;*

Rekomandimi 3: *“Institucioni, të rishikojë planin mësimor me qëllim përfshirjen e praktikës profesionale si element i detyrueshëm kurrrikular”*.

KU Logos ka rishikuar planin mësimor, si dhe është përfshirë praktika profesionale në programin e studimit. IAL ka realizuar ndërkohë dhe disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione për dërgimin e studentëve në praktikat profesionale. *GVJ konstaton përmbushjen “plotësisht” të rekomandimit;*

Rekomandimi 4: “Institucioni, të realizojë një studim të mirefilltë të tregut të punës për këtë program studimi”

GVJ konstaton që KU Logos ka bërë një studim për punësimin e studentëve pas diplomimit ndërkohë nuk kemi një evidencë të qartë në lidhje me studimin e tregut të punës. Gjithsesi, konsiderohet që fusha është prioritare dhe kërkesa për këto profile është gjithmonë në rritje. Por, IAL duhet të konfirmojë që formimi i këtyre studentëve është i aktualizuar dhe në një linjë me tregun e punës. **GVJ konstaton përmbushjen “kryesisht” të rekomandimit;**

Rekomandimi 5: “Institucioni, të kryejë një analizë të punësimit të studentëve të këtij programi studimi dhe të shtojë përpjekjet për rritjen e bashkëpunimit me kompani që veprojnë në sektorin e TIK, për të ndihmuar në punësimin e studentëve”;

KU Logos ka ngritur zyrën e Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë funksionon në bazë të Rregullores “Mbi Funksionimin e Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës në Kolegjin Universitar “Logos” të miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.20 datë 23.03.2020 [Ev: aneks 10]. Zyra drejtohet nga Koordinatori dhe një numër studentësh vullnetare të cilët japin asistencë në aktivitetet që kjo zyrë ndjek [Ev: aneks 10, neni 4]. Neni 4 në Rregulloren e zyrës së Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës përcakton qartë punën e kësaj zyre në drejtim të këshillimit dhe dhënies së udhëzimeve në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale.


Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës mbledh të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve duke ndjekur studentët e diplomuar [Ev: aneks 46.1.16; aneks 46.1.16.2]

	Numri total i studentëve të diplomuar	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
2018-2019	15	7	8
2019-2020	10	3	7
2020-2021	14	9	5

Bashkëpunimet me kompanitë e biznesit janë në fokus të veprimtarisë së Departamentit të Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës. Në raportet vjetore një pikë e vecantë është pasqyrimi i marrëveshjeve të reja që njësia bazë ka nënshkruar me kompanitë private në drejtim të bashkëpunimeve dhe zhvillimit të praktikës profesionale [Ev: aneks 24.1, aneks 24.2, aneks 24.3; aneks 24.4]. **GVJ konstaton përmbushjen “plotësisht” të rekomandimit;**

Rekomandimi 6: “Institucioni, të vijojë me pasurimin dhe përditësimin e bibliotekës me tituj në fushën e TIK”.

Pasurimi i bibliotekës ka qenë në fokus të plan veprimit në drejtim të përmbushjes së rekomandimit të dhënë nga Bordi i Akreditimit. Gjatë tre viteve të fundit ky program studimi është pasuruar me 63 libra (39 në gjuhën shqipe, 15 në greqisht, 9 në anglisht) dhe 50 tituj (26 në shqip, 15 në greqisht dhe 9 në anglisht). Kërkesat për pasurimin e saj burojnë nga



Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës dhe prokurohet pas miratimit të dhënë nga Administratori. GVJ në vizitën e kryer konstaton pasurimin e stendave të librave në fushën e informatikës. Edhe pse titujt janë të autorëve më në zë të fushës, përsëri sugjerojmë marrjen e botimeve të reja, në mënyrë që informacioni në to të jetë sa më aktual. Në vizitë u konstatua puna që duhet bërë në drejtim të mënyrës së katalogimit të librave në stenda për të krijuar me lehtësira të studentëve. **GVJ konstaton përmbushjen “plotësisht” të rekomandimit.** [Ev: aneks 33.2; aneks 33.3; aneks 33.4, aneks 33.5, aneks 33.6, vizitë në institucion]


PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Gusht 2022. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur KU Logos për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. KU Logos, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat per hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialisti i ASCAL, Msc. Majlinda Demireli. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, Përgjegjësin e Departamentit të Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës, takim me stafin akademik, takim dhe intervista me studentët e programit të studimit, me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, me grupin e vlerësimit të jashtëm, me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokollit dhe Arkivës, me përfaqësues të Zyrës së Projekteve dhe me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore.

Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u



fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Kolegji Universitar “LOGOS”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.04.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 133 Prot, datë 03.04.2023. Kolegji Universitar “LOGOS”, përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 87/1 Prot, datë 07.04.2023, “Përgjigje tuajës datë 03.04.2023, lidhur me dërgimin e draft raportit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit”, ku Kolegji shpreh dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Drafti merr formën e Raportit Final.

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	GVJ arrin në përfundimin se Programi i studimit “Informatikë e Zbatuar”, ofruar nga Kolegji Universitar Logos, është në përputhje dhe në harmoni me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me to. Madje, Informatika apo degë të ngjashme, janë sugjeruar si ndër profesionet më të kërkuara nga organizma të ndryshëm. GVJ përcjell dhe faktin që informatika e zbatuar në fusha të ndryshme konsiderohet si ndër aspektet zhvillimore më të rëndësishme apo subjekt i projekteve të ndryshme europiane. Për të dyja këto arsye, KU LOGOS dhe njësia bazë kanë vendosur hapjen e degës “Informatikë e Zbatuar”. [Ev. Aneks 1]
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi Bsc në “Informatikë e Zbatuar” ndjek vizionin e shprehur në strategjinë e KU LOGOS [Ev. Aneks 11.2], sipas të cilit IAL synon të ndërthurë edukimin me kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive. Ky vizion ruan e konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me	Në Statutin e KU LOGOS [Ev. Aneks 1], si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit [Ev. Aneks 6] konfirmohet që programet e studimit të ciklit të parë, ndër të

qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	cilët dhe “Informatika e Biznesit”, ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e KU LOGOS si dhe Fakulteteve dhe Departamenteve brenda tij, në përputhje me strategjinë për zhvillim të KU LOGOS.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Sipas RVB, institucioni ka kryer analiza si dhe ka hulumtuar studime zyrtare të organizatave shtetërore dhe private, vendase dhe të huaja, si dhe nga nevojat e bizneseve me të cilët KU LOGOS ka komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Rezultat i kësaj analize ishte dhe hartimi i programit të studimit Bsc në “Informatikë e Zbatuar”. Meqënëse, profesionistët e rinj që përfundojnë studimet në këtë program kanë natyrë pothuajse ndërdisiplinare, ata mund të themi që integrohen mirë në sektorë të ndryshëm duke kontribuar kështu dhe në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. [Ev. Aneks 11.1]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	IAL e shpreh qartë në objektivat strategjike të Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional 2018-2024 [Ev. Aneks 2; Aneks 3], që institucioni ofron programin e studimit në përputhje me strategjinë për zhvillim të KU LOGOS-së. GVJ e konstaton këtë dhe në bazë të përmbajtjes së programit të studimit, sipas të cilit një i diplomuar në “Informatikë e Zbatuar” ndërthur drejtimin e Informatikës me atë të Ekonomisë/Biznesit.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në dokumentin e “Statutit” dhe “Plani Strategjik i KU LOGOS” [Ev. Aneks 1; Aneks 2; Aneks 3] specifikohen drejtimit prioritar të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara. Sipas tij, FSHA ka pasur si fokus të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe	Programi i Studimit Bsc në “Informatikë e Zbatuar”, është një program që përmbush vizionin aktual të KU LOGOS, të

përbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	përcaktuar në statutin e KU LOGOS dhe planin strategjik. [Ev. Aneks 1]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit bachelor në Informatikë e Zbatuar” [Ev. Aneks 16] janë renditur objektivat kryesorë formues të programit të studimit, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ngrejë në cilësi më të lartë njohuritë profesionale dhe shkencore të përfutuara nga studimet bachelor; - Të përgatisë specialistë të aftë për zgjidhjen e problemeve nëpërmjet programeve kompjuterike në institucionet bankare, shoqërive të sigurimit, kompanitë e biznesi dhe në administrate; - Të krijojë figurën e ekspertit në fushën e informatikës dhe teknologjisë së informacionit, të realizojë programimin e projekteve në institucionet financiare dhe kompanitë e biznesit; <p>Po në të njëjtën evidencë, ky program shprehet se përgatit specialistë IT, zhvillues aplikacionesh, specialistë rrjetesh kompjuterike dhe administrues sistemesh operativë. Ndërkohë konstatojmë që në bazë të lëndëve të strukturës mësimore [Ev. Aneks 6] nga ky program mund të kemi dhe mjaft profesione të tjerë të orientuar nga analiza e të dhënave, administrimi i databazave, apo dizenjimi grafik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe</p>	<p>IAL përmban në strukturën e vet administrative disa njësi të rëndësishme, të cilat kanë funksionalitete të ndryshme në ndihmë të përmirësimit të marrëdhënieve të tij me tregun e punës. Kështu, GVJ konstaton që KU Logos ka bërë një studim për punësimin e studentëve pas diplomimit [Ev. Aneks 12], ndërkohë nuk kemi një evidencë të qartë në lidhje</p>

<p>në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p><i>me studimin e tregut të punës përpara hapjes së tij.</i> Gjithsesi, konsiderohet që fusha është prioritare dhe kërkesa për këto profile është gjithmonë në rritje. Por, IAL duhet të konfirmojë që formimi i këtyre studentëve është i aktualizuar dhe në një linjë me tregun e punës.</p> <p>Përmbajtja e dokumenteve, si dhe gjatë vizitës, u konstatua që programi i studimit garanton përftimin e dijeve, kompetencave dhe disa thellime në profesione të caktuara brenda IT, të cilat i përgjigjen tregut local të punës.</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënësit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.4</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Sipas RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar nga IAL [Ev. Aneks 30; Aneks 13.1; Aneks 51], IAL dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ofron kapacitete dhe burimet e duhura akademike për ofrimin e programit në Informatikë e Zbatuar. Në shërbim të këtij programi për vitin akademik 2021-2022, janë të angazhuar në mësimdhënie 16 pedagogë, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 6 me kohë të plotë (PAE) - 10 me kontratë (PAK)

	Duke pasur një numër të vogël studentësh, në bazë të një Marrëveshjeje me MAS, lejohet që DIZS të ketë këtë përbërje stafi. Nga vizita u panë mjediset e zhvillimit të mësimit, të zyrave, të stafit, apo ambientet e tjera, të cilat janë në përputhje me kriterin.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e programit të studimit “Informatikë e Zbatuar” është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore “Shkenca të Aplikuara”. Përpos përmbajtjes, <i>GVJ sugjeron që të mos kemi dyjëzim të të njëjtin term në emërtimin e Degës dhe Fakultetit, pra, ose Shkenca të Zbatuara dhe Informatikë e Zbatuar, ose Shkenca të Aplikuara dhe Informatikë e Aplikuara. [Ev. Aneks 1]</i> Programi i studimit i Informatikë e Zbatuar është program i ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale është tri vite akademike.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit “Informatikë e Zbatuar” është konceptuar dhe hartuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore specifike të Departamentit të Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës që është: "Informatikë e Zbatuar" dhe fushën e përgjithshme të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara. [Ev. Aneks 1; Aneks 3]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të

realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që IAL i jep rëndësi të veçantë analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Kështu, shohim së në këto analiza në vëmendje të tyre janë: Programet e studimit; Procesi mësimor; Stafi akademik; Studentët; Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm; dhe Veprimtaria ndihmëse. Gjithashtu, sipas RVB, shihet që FSHA realizon çdo vit vlerësimin e ecurisë së Programeve të Studimit, bazuar në Indikatorët themelorë: Kurrikula e Studimeve, Planet Mësimore dhe Programet mësimore të cdo moduli. Hartimi dhe modifikimi i secilit prej tyre është përgjegjësi e Njesisë Bazë e cila organizon procesin me angazhimin e stafit akademik, apo të njësive të tjera bazë që janë të angazhuara në këtë program studimi [Ev. Aneks 50]. Analiza synon të evidentojë arritjet dhe problematikat me synim rishikimin e objektivave për përmirësimin e vazhdueshëm të ecurisë së Programit të Studimit dhe procesit mësimor në tërësi.</p>										
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, si dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuar GVJ konstaton që KU LOGOS ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh dhe homologesh ndërkombëtare dhe vendas [Ev. Aneks 23.5] në funksion të ofrimit të mundësisë të shkëmbimit të dijeve, si dhe një marrëveshje me një kompani privatë në fushën e programimit [Ev. Aneks 23.4]. Në tabelën më poshtë përmblihen marrëveshjet e bashkëpunimit:</p> <table border="1" data-bbox="628 1368 1362 1738"> <tbody> <tr> <td>IAL vendase, publike dhe private</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>IAL ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Institucione joarsimore shqiptare</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>Institucione në kuadër të praktikave profesionale</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Institucione të arsimit parauniversitar shqiptare</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table>	IAL vendase, publike dhe private	9	IAL ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+	8	Institucione joarsimore shqiptare	26	Institucione në kuadër të praktikave profesionale	4	Institucione të arsimit parauniversitar shqiptare	9
IAL vendase, publike dhe private	9										
IAL ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+	8										
Institucione joarsimore shqiptare	26										
Institucione në kuadër të praktikave profesionale	4										
Institucione të arsimit parauniversitar shqiptare	9										
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Studentë të gjithë Fakulteteve të KU LOGOS bëhen çdo vit pjesë e programeve të shkëmbimit me universitete dhe organizata në kuadër të programeve ERASMUS+.</p>										
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara mban evidenca të përvitshme të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit,</p>										

dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	në terma të numrit të praktikave profesionale apo mobiliteteve të realizuara [Ev. Aneks 24.1].			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në lidhje me këtë kriter, GVJ konstaton që KU Logos nuk ofron trajnime të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësin, por ata bashkëpunojnë ngushtë për programet e praktikave profesionale të zyrtarizuara tashmë në program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Në të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, konstatohet që programi i studimit “Informatikë e Zbatuar” është organizuar në lëndë, të cilat vlerësohen me kredite në bazë të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, në bazë të Rregullores së Fakultetit, lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese. Struktura dhe përmbajtja e programeve mësimore është në përshtatje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Programi i studimit “Informatikë e Zbatuar” përmban 180 ECTS dhe është i organizuar në tre vite akademike (6 semestra), ku cdo vit ka 60 ECTS [Ev. Aneks 6].
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson programin e studimit “Informatikë e Zbatuar” si një profil mjaft të domosdoshëm në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit. Struktura mësimore e programit përmban lëndë të cilat lejojnë që në fund të programit të studimit, të diplomuarit të mund të

<p>profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>orientohen/punësohen në një larmi profesionesh brenda IT, në nivel fillestar e jo të thelluar [Ev. Aneks 1].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, në bazë të RVB, si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konstaton që programi Bsc në “Informatikë e Zbatuar pasqyron në planin mësimor disiplina mësimore bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës [Ev. Aneks 51, Tabela 10.3].</p> <p>Në vitin e parë të studimeve studenti përvetëson 15 lëndë me jo vetëm njohuri të përgjithshme dhe formuese (si Matematikë, Greqisht, Anglisht), lëndë bazike informatike (Njohuri informatike), si dhe lëndë të disiplinës së Informatikës (si Përdorim dhe administrim i sistemeve Windows, Programim të Dhënash, Bazë të dhënash). Në fund të vitit të parë një student i programit “Informatikë e Zbatuar” ka marrë njohuri të fushave të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në vitin e dytë të studimeve vihet re që nga 14 lëndë, kemi këtë kategorizim: 10 lëndë informatike, 4 të përgjithshme. Në fund të këtij viti studenti ka thelluar njohuritë e tij sidomos në disa prej shtyllave kryesore të Informatikës si Programimi, Dizajnimi dhe Rrjetat.</p> <p>Viti i tretë i studimeve përmban 9 lëndë informatike, si dhe praktikën profesionale dhe tezën bachelor. Në përfundim të vitit të tretë studenti duhet të ketë përvetësuar dhe çështje më komplekse teknike, si sistemet e shfrytëzimit dhe Linux, Arkitektura e kompjuterit, multimedia, etj.. [Ev. Aneks 51, Tabela 10.3]</p> <p>Renditja e lëndëve të të tre viteve duket se nuk thellon formimin e studentëve, por nga ana tjetër e zgjeron atë në disa drejtime informatike, duke krijuar kështu profesionistë të mesëm.</p> <p>Konstatohet që nuk ka një lëndë që zhvillon mendimin kritik, shkrimin akademik, apo metodat e kërkimit. Pjesa e kërkimit shkencor shihet gjithashtu shumë pak e reflektuar në programet e veçanta lëndore të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që për të zhvilluar aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme, studenti duhet të trajnohet në kryerjen e kërkimit shkencor.</i></p> <p>Por vlen të theksojmë që këto aftësi në të vërtetë është e vështirë të plotësohet nga programe studimi bachelor. Nga ana</p>

	tjetër vlerësojmë nxitjen e IAL për pjesëmarrje të studentëve në konferenca.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Sipas RVB, referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, programi i studimit në “Informatikë e Zbatuar” plotëson të gjithë elementët për një strukturë korrekte dhe bashkëkohore. Programi i studimit është i ndarë në module të mirëfillta të cilët nuk kanë mbivendosje midis tyre dhe janë me karakter formues dhe profesional. Çdo modul ka të specifikuar qartë kreditet (ECTS) në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë. [Ev. Aneks 6].
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Duke iu referuar dokumentacionit mbështetës të dorëzuar nga IAL, konstatojmë që programi i studimit në Informatikë e Zbatuar i ndan veprimtaritë formuese, lëndët, në disiplina të ndryshme (“Rregullore e Programit të Studimeve Bachelor në Informatikë e Zbatuar” [Ev. Aneks 6]). Gjithsej janë 35 lëndë dhe shpërndarja e tyre në kategori është si më poshtë: Kategoria A: 31.5 ECTS > 17.5 % Kategoria B: 94.5 ECTS > 52.5 % Kategoria C: 21 ECTS > 12 % Kategoria D: 27 ECTS > 15 % Kategoria E: 6 ECTS > 3.5 % Sipas Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019, Shtojcë nr. 1, elementët e programeve të studimit përcaktohen si më poshtë, të cilat plotësohen nga IAL.




	shkencore, përgjegjës për grupet mësimore dhe shkencore, përzgjedhin fituesit e programit të studimit. Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe Statistikë, referuar ligjit të arsimit të lartë 80/2015 (neni 14, 15), përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin nga ASCAL, në sajë të një marrëveshjeje me MAS.						
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësies përkatëse.</p>	<p>IAL ka përcaktuar drejtuesin e departamentit për të qenë koordinor i programit Bsc në “Informatikë e Zbatuar” që kur ky program do të hapej [Ev. Aneks 50]. Ai gjithashtu kujdeset për mbarëvajtjen e praktikave profesionale si dhe informon titullarin në lidhje me proceset apo problematikat e punës.</p>						
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe Statistikë është përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e programit të studimit “Informatikë e Zbatuar”. Ai gjithashtu është përgjegjës për propozimin e kritereve pranuese të studentëve në programin e studimit Bsc në “Informatikë e Zbatuar”, kritere të cilat miratohen dhe nga njësia kryesore FSHA [Ev. Aneks 4].</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ka në përbërje 3 njësitë bazë:</p>						
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>1. Departamenti Informatikë së Zbatuar dhe Statistikës;</p> <p>2. Departamenti i Shkencave të Shëndetit dhe të Mirëqënies Sociale;</p> <p>3. Departamenti i Shkencave Mjekësore;</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në vitin akademik aktual 2021-2022, ka 28 staf akademik gjithsej, ku 15 janë pedagogë me kohë të plotë, dhe 13 pedagogë me kohë të pjesshme. [Ev. 51 tab 1].</p>						
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit,</p>	<table border="1" data-bbox="587 1839 1355 1993"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1839 1050 1935">Fakulteti i Shkencave të Aplikuara</th> <th data-bbox="1050 1839 1201 1935">PAE</th> <th data-bbox="1201 1839 1355 1935">PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1935 1050 1993">Prof. Dr.</td> <td data-bbox="1050 1935 1201 1993">3</td> <td data-bbox="1201 1935 1355 1993">1</td> </tr> </tbody> </table>	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara	PAE	PAK	Prof. Dr.	3	1
Fakulteti i Shkencave të Aplikuara	PAE	PAK					
Prof. Dr.	3	1					

përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Prof. As. Dr.	2	2
Dr. / PhD.	4	7
MSc.	6	3
Në total	15	13
Totali	28	

Referuar nenit 25, Ligjit Nr 80/2015, *njësia bazë duhet të ketë në përbërje të saj, të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.* Për shkak të numrit të ulët të studentëve, KU “LOGOS” ka marrë miratimin e MASR, dhe është pranuar që numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë për departamentet të jetë 5, nga të cilët dy prej tyre të kenë gradë apo titull shkencor dhe se personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë, për çdo rast, jo më pak se 70% të ngarkesës. *(Aneks 41.11 Marreveshje MAS, Reduktimi i numrit të personelit akademik në njësine baze)*


Sipas [Ev 51 tab 2]. personeli akademik i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit për tre vite akademike paraqitet si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	0	3	0	1	0	1
Dr./PhD.	1	2	1	3	0	4
Msc.	4	4	3	3	5	1
Totali	6	10	5	8	6	7

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3


Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në KU Logos që ofron programin e studimit, zotëron gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Departamenti i Informatikë së Zbatuar dhe Statistikës disponon gjithë informacionin e nevojshëm elementet e programit të studimit Bsc në Informatikë e Zbatuar siç janë struktura e vitit akademik, kuotat e pranimit dhe grupet mësimore, kurrikula dhe plani mesimor, mënyra e vlerësimit të studentëve, praktika profesionale dhe diplomimi. Rregullorja e njësisë kryesore FSHA bën përcaktimin e standarteve në lidhje me përgatitjen, organizimin dhe administrimin e studimeve universitare [Ev. Aneks 6; Aneks 47.1].</p> <p>Gjithashtu, bazuar në këtë rregullore, Dekani miraton rregulloret e programeve të studimit të njesive bazë.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bsc në “Informatikë e Zbatuar organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese. Këto të dhëna detajohen në rregulloren e programit të studimit [Ev. Aneks 6], si dhe pasqyrohen në të dhëna të ndryshme tabelare në dokumentacionin e dorëzuar.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në lëndë/module të vlerësuara me kredite (ECTS) të ndara në mënyrë proporcionale në vite. Në tre vite akademike realizohen 180 ECTS</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton që IAL ka dhe organizon shumë mirë dokumentacionin me anë të së cilit ka argumentuar kriteret procesin e akreditimit, si dhe gjatë vizitës u pa mirëorganizimi i tyre. Edhe në rasin e syllabuseve [Ev. Aneks 51, Tabela 14.3], pasqyrohen programet për lëndët e vitit 2022-2023, të grupuara sipas moduleve, si dhe me të gjithë elementët që kërkon ligji. Këto syllabuse përmbajnë një pjesë të rëndësishme të informacionit në lidhje me orët mësimore; numri i ECTS, detyrimet e modulit, vlerësimi i studentit, si dhe literatura. Pothuajse cdo lëndë vlerëson studentët me 40% të pikëve gjatë semestrit dhe 60% në provimin final.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të</p>	<p>Rregullat për frekuentimin si dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara dhe në programet e vecanta lëndore, si</p>

<p>gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>dhe në dokumentin e sipërcituar. Ato ndjekin Rregulloren e KU LOGOS.</p> <p>Në dokumentin “Vendimi i departamentit për kriteret e pranimit të studentëve”, [Ev. Aneks 40.13] për vitin 2022-2023. IAL nuk ka kritere për përzgjedhjen e studentëve, përvec mesatares.</p> <p>Në rregulloren e programit saktëson procesin e transferimeve të studentëve që vijnë në programin e studimit “Informatikë e Zbatuar”. Ky kalim konsiderohet i vlefshëm kur departamenti të ketë njohur plotësisht ose pjesërisht kreditet e grumbulluara nga studenti.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në RVB si dhe në dokumentacionin e dorëzuar, konfirmohet që për programin e studimit Bsc në Informatikë e Zbatuar çdo fillim viti akademik hartohet dosja e plotë e këtij programi studimi e cila përmban syllabuset për secilën lëndë, kurrikulën, planin mësimor, ngarkesën e plotë të stafit akademik, strukturën e vitit akademik etj. Syllabusi përmban gjithë informacionin e nevojshëm për secilën lëndë që ofron programi në çdo semestër studimi referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018. Programet lëndore ndjekin të gjithë të njëjtin format.</p> <p>Syllabuset e detajuara për çdo lëndë janë dhe të aksesueshme online në web-site-n personal të stafit akademik përgjegjës për modulin. Ato janë të plota dhe ofrojnë informacion të detajuar mbi: të dhënat të përgjithshme të lëndës, qëllimi dhe objektivat, kalendari i temave, forma e vlerësimit, literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar etj.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita në institucion gjatë takimeve me anëtarë drejtues të njëjësive bazë dhe kryesore se programet mësimore dhe përmbajtjet e tyre lëndore janë në përmirësim të vazhdueshëm, në fillim të çdo viti akademik [Ev. Aneks 40.1; Aneks 39; Aneks 28.1]. Kjo konsiderohet si një aspekt pozitiv dhe shpesh i domosdoshëm për profile teknike si ai i programit të studimit në “Informatikë e Zbatuar”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4



Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ evidentoi që ngarkesa e programit të studimit në programin “Informatikë e Zbatuar”, prej 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademik është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me raportet mes orëve të leksioneve dhe seminareve, GVJ konstaton që ato ruhen në mënyrë të kënaqshme.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ, pas një shqyrtimi të detajuar të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve, të shpërndarjes së lëndëve [Ev. Aneks 51, Tabela 14.3], <u>sugjeron që:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Lënda Njohuri Informatike – Përpunim teksti të riemërtohet si Shkrim Akademik dhe të marrë pak më tepër trajtën e kësaj lënde. • Lënda Njohuri Informatike – Llogaritje të kompjuterizuara, mund të shkrihet me Hyrje në Informatikë; • Lënda Njohuri Kompjuterike – Hyrje në Informatikë, ka shumë tema të Arkitekturës së sistemeve kompjuterike, të cilat e dominojnë lëndën • Lënda Përdorim dhe Administrim i sistemeve Windows, nuk duket se justifikon numrin prej 9 ECTS, mund të konsiderohet e parakohshme për një student të vitit të parë, semestri i parë, ndërkohë që nuk ka marrë ende konceptet e Sistemeve të Shfrytëzimit. Kjo është një lëndë e vecantë në semestrin IV, e më pas bëhet Linux në semestrin VI. Të tre këto lëndë duhet të shkrihen në 2, të bëhet rirënditje (në fillim SSh, më pas Windows dhe Linux bashkë), në semestrat III dhe IV; • Lëndët Matematikë 1 dhe 2, përvec teorisë, mund të konkretizojnë seminarët me përpunimin e informacionit, përdorimin e mjeteve dhe informatizimin e aparatit matematikor, e kjo të përcaktohet në syllabus (Shembull: lënda Gjuha Angleze); • Lënda Programim të dhënash ka prerje me lëndën Hyrje në Informatikë, dhe me lëndën që vjen më pas Programim në C. Të rakordohen dhe ndahen temat mes tre lëndëve;

	<ul style="list-style-type: none"> • Lënda Bazë të dhënash, me të dy modulet e saj, bëhet në semestrat I dhe II, sugjerojmë të shtyhet për në II+III ose III+IV, në mënyrë që studenti të jetë më në gjendje të abstragojë dhe kuptojë queries, normalizimet, apo sintaksa të tjera të SQL. Studentëve në këto lëndë duhet tu jepen projekte me pikë, përvec provimit të ndërmjetëm. Po ashtu dhe në disa lëndë të tjera, të shtohen projektet dhe pikët e caktuara për to; • Lënda Rrjeta Kompjuterike ka 3 module. Sugjerojmë që dy modulet e parë të bashkohen në një, si dhe moduli i tretë të Riemërtohet si Siguria e Sistemeve (p.sh.) e të jetë më e përgjithshme për sigurinë e informacionit si përmbajtje ndërdisiplinare; • Lënda Programim ka 3 module. Sugjerojmë që të riemërtohet si Programim i Avancuar, meqë 3 modulet e saj zhvillojnë teknologjitë .Net, Php, Oracle; • Lënda Sisteme Shfrytëzimi të zhvillohet në semestrin III, ose IV; • Lënda Arkitektura x86 të zhvendoset në semestrin II, ose III, para se të fillojnë lëndët e rëndësishme të programimit, sic logjikisht duhet të ndodhë me rrjedhën e përvetësimit të dijeve të një specialisti IT (Harduer -> SSh -> Softuer). • Programi nuk përmban asnjë lëndë Statistike, Probabiliteti, apo të tilla si Machine Learning, Inteligjencë Artificiale, Inxhinjerim Softuerësh, etj, që janë klasike për programet e shkencave kompjuterike, aq më tepër të zbatuara në një fushë të dijes; <p><i>Sugjerimet e mësipërme ndihmojnë në strukturimin më të mirë të njohurive dhe aftësive të studentëve, e për pasojë pozicionimin dhe punësimin më të mirë të tyre në tregun lokal, gjithsesi IAL mund të konsiderojë të gjitha ose një pjesë të tyre.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme</p>	<p>Lëndët dhe modulet e ofruara <i>Ev. Aneks 51, Tabela 14.3]</i> mbulojnë fushat e studimeve të informatikës dhe biznesit duke ju mundësuar studentëve profilizimin në specializime të ndryshme profesionale. Departamenti në përfundim të çdo viti akademik realizon një analizë të punës dhe pjesë e kësaj analize është rishikimi i kurrikulës duke e përshtatur me tregun e punës.</p>

të të nxënit dhe aftësimin profesional.																																									
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në fushën e IT (në nivel programuesi junior ose si specialist IT), por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore në lëndë të vecanta aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore, nga të cilat do të përfitojë studenti. Nevojitet të theksohet më shumë mendimi kritik nëpërmjet kërkimit shkencor dhe ngritjes së hipotezave, matjeve, eksperimenteve, mbledhjes së të dhënave, analizës dhe parashtrimit të rezultateve. <i>Kjo është pjesa që mungon në programin e studimit Bsc në "Informatikë e Zbatuar", pjesë që në fakt është e rëndësishme në programe të ngjashme ndërkombëtare.</i> Është për t'u vlerësuar fakti që departamenti i Informatikë e Zbatuar dhe Statistikës çdo fund viti kalendarik zhvillon analizën e punës mësimore dhe shkencore, ku diskutohet ndër të tjera edhe mbi arritjet e objektivave formuese të programit Informatikë e Zbatuar.</p> <p>Raporti Teori /Praktikë, i përllogaritur si raporti: (orë totale leksioni) / (orë Seminari + Lab + Ushtrime + praktike), në programin "Informatikë e Zbatuar" nëse përllogaritet në bazë të dokumentit "Plani Mësimor" <i>Ev. Aneks 51, Tabela 14.3</i>], do të figurojë që:</p> <table border="1" data-bbox="564 1191 1362 1711"> <thead> <tr> <th>Semestri</th> <th>Leksion Orë/ECTS</th> <th>Seminar Orë/Ects</th> <th>Ushtrime Orë/ECTS</th> <th>Laborator Orë/ECTS</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>I</td> <td>135/13.5</td> <td>105/10.5</td> <td></td> <td>60/6</td> </tr> <tr> <td>II</td> <td>135/13.5</td> <td>105/10.5</td> <td></td> <td>60/6</td> </tr> <tr> <td>III</td> <td>150/15</td> <td>90/9</td> <td></td> <td>60/6</td> </tr> <tr> <td>IV</td> <td>135/13.5</td> <td>75/7.5</td> <td></td> <td>90/9</td> </tr> <tr> <td>V</td> <td>135/13.5</td> <td>75/7.5</td> <td></td> <td>90/9</td> </tr> <tr> <td>VI</td> <td>75/7.5</td> <td>75/10.5</td> <td></td> <td>6/6</td> </tr> <tr> <td>TOTAL</td> <td>765/76.5</td> <td>525/55.5</td> <td>0/0</td> <td>420/42</td> </tr> </tbody> </table> <ul style="list-style-type: none"> - Total: 180 ECTS - Praktika: 6 ECTS - Diploma: 6 ECTS - Lëndët: 168 ECTS 	Semestri	Leksion Orë/ECTS	Seminar Orë/Ects	Ushtrime Orë/ECTS	Laborator Orë/ECTS	I	135/13.5	105/10.5		60/6	II	135/13.5	105/10.5		60/6	III	150/15	90/9		60/6	IV	135/13.5	75/7.5		90/9	V	135/13.5	75/7.5		90/9	VI	75/7.5	75/10.5		6/6	TOTAL	765/76.5	525/55.5	0/0	420/42
Semestri	Leksion Orë/ECTS	Seminar Orë/Ects	Ushtrime Orë/ECTS	Laborator Orë/ECTS																																					
I	135/13.5	105/10.5		60/6																																					
II	135/13.5	105/10.5		60/6																																					
III	150/15	90/9		60/6																																					
IV	135/13.5	75/7.5		90/9																																					
V	135/13.5	75/7.5		90/9																																					
VI	75/7.5	75/10.5		6/6																																					
TOTAL	765/76.5	525/55.5	0/0	420/42																																					



	<p>Orët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksion 765 orë; - Seminare 525 orë; Laborator 420 orë - Total orë: 1710 orë <p>Sipas përlllogaritjeve, raporti Teori/Praktikë qëndron si 765 / (525 + 420), pra është në nivelet 45% / 55%. Ky është një raport mjaft i mirë për ciklin Bachelor.</p>												
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Sipas Dokumentacionit (Ev. Aneks 51, Tabela 14.3, RVB), programi i studimit konsiderohet në përputhje me komponentët mësimorë që përbëjnë aftësitë formuese. Programi i studimit ka shumë lëndë që i përkasin programit të studimit Informatikë e Zbatuar në tërësinë e tyre, ku ruhen raportet midis formimit teorik dhe praktik.</p>												
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e moduleve janë përshtatur referuar VKM Nr. 41, por duhet të cilësojmë që literaturat e tyre është e nevojshme të rifreskohen, si dhe të citohen sipas standarteve të mirënjohura, në mënyrë që departamenti të jetë gjithmonë i përditësuar për përmbajtjet e lëndëve të programit të studimit “Informatikë e Zbatuar”. GVJ konstaton që në pjesë më të madhe të rasteve në syllabus, tek seksioni “Literaturë e detyruar” pedagogët kanë vendosur “Cikël leksionesh”. Këto janë materiale që ne e mirëkuptojmë, që janë të përgatitura dhe përditësuara, por konsiderohen si “materiale të kursit/lëndës” që studentët duhet t’i përvetësojnë, por jo literaturë në të cilën mbështetet korpusi i lëndës.</p> <table border="1" data-bbox="563 1485 1359 1960"> <thead> <tr> <th>Lënda</th> <th>Viti më i ri tek “Lit. Bazë”</th> <th>Viti më i ri tek “Lit. e Rekomanduar”</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Njohuri informatike dhe aplikacione bazë</td> <td>2010</td> <td>2016</td> </tr> <tr> <td>Përdorim dhe administrim i sistemeve Windows</td> <td>N/A</td> <td>2016</td> </tr> <tr> <td>Matematikë</td> <td>2010</td> <td>2009</td> </tr> </tbody> </table>	Lënda	Viti më i ri tek “Lit. Bazë”	Viti më i ri tek “Lit. e Rekomanduar”	Njohuri informatike dhe aplikacione bazë	2010	2016	Përdorim dhe administrim i sistemeve Windows	N/A	2016	Matematikë	2010	2009
Lënda	Viti më i ri tek “Lit. Bazë”	Viti më i ri tek “Lit. e Rekomanduar”											
Njohuri informatike dhe aplikacione bazë	2010	2016											
Përdorim dhe administrim i sistemeve Windows	N/A	2016											
Matematikë	2010	2009											

Programim të dhënash	2010	2007
Bazë të dhënash	N/A	N/A
Anglisht	2012	2017
Greqisht	2014	N/A
Programim i OO në C++	N/A	N/A
Web Design	2013	2011
Rrjeta Kompjuterike	N/A	2015
Java	N/A	2017
Lëndë me formim Design	N/A	2019
Linux	N/A	2019
Përpunime multimediale	N/A	N/A
Programim	N/A	2014
Sisteme Shfrytëzimi	N/A	N/A
Analizë të dhënash	N/A	N/A
Arkitektura x86 Gjuha Asembler	2018	2003
Total 18 / Të përditësuara	1/18	4/18

*N/A: literatura ekziston por nuk ka aplikuar standartin e referimit të burimeve dhe viti i botimit mungon.

Nga 18 grup-lëndë të marra në analizë nga GVJ, konstaton që në vetëm 1 prej tyre është e përditësuar literature bazë, në 4 është e përditësuar literature e rekomanduar dhe në 61% të rasteve mungon viti.

GVJ rekomandon përditësimin e literaturës, pasi mungesa e përditësimit të përmbajtjeve lëndore mund të sjellë dobësim të rezultateve të prishme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.

Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e

Referuar Rregullores së FSHA programet e studimit janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin

<p>dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që ky program të orientohet pak më tepër drejt zbatueshmërisë në biznes, që të justifikohet dhe emërtimi i programit të studimit, ose të lihet thjesht Informatikë.</i></p> <p>Në këtë mënyrë ky program do gjendej saktësisht brenda njësisë së tij dhe mbi të gjitha do të plotësonte një drejtim kombëtar mjaft të rëndësishëm, siç është ai i digjitalizimit të proceseve të biznesit. Në vijim të sugjerimit, vendosja e një ose dy lëndëve të tjera me natyrë menaxheriale, por bashkëkohore dhe të aplikueshme në biznes, do e plotësonte më së miri këtë emërtim.</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Informatikë e Zbatuar është në konformitet me përcaktimet e bëra në Vizionin dhe Misionin e KU LOGOS, si një program i rëndësishëm studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive. Është një fushë studimi me profil Teknik dhe rezulton se të diplomuarit në këtë program studimesh janë të kërkuar në tregun e punës. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë e Zbatuar”, është në dobi dhe në mbështetje të nevojave dhe kërkesave për një lloj diversifikimi të mëtejshëm të diplomave që ofron FSHA, në dobi të studentëve që pranohen në këtë fakultet.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Të diplomuarit në këtë program studimesh mund t’i përgjigjen mjaft mirë nevojave të vendit. Ritheksojmë që këto prioritet janë të qarta për FSHA dhe DIZS, por sikurse i sugjeruam dhe në kriterin e mësipërm, duhet të konkretizohen më fort në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p>Vetë studentët e degës, gjatë vizitës në IAL, shprehën mungesën e implementimit të njohurive të marra në praktikë në përgjithësi, por gjithsesi ishin mjaft të kënaqur me profilin që kishin marrë, si IT të ardhshëm. FSHA ka nënshkruar gjithashtu mjaft marrëveshje bashkëpunimi me bizneset, në të cilët studentët realizojnë praktikat mësimore, gjejnë mundësi punësimi, si dhe ka konsulta të ndërsjellta mes tyre dhe stafit akademik në kuader të përmirësimit të programeve të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit “Informatikë e Zbatuar” është me grada dhe tituj, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.</p> <p>Sipas VKM nr. 418, janë përcaktuar raportet e personelit akademik me kohë të plotë/student, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore.</p>																																																
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga të gjithë module që zhvillohen (pa përfshirë praktikën profesionale), të gjitha modulet mbulohe nga personel akademik efektiv.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë e Zbatuar”, bazuar në tabelat [Ev 51 tab 6] është:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2021 – 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 6 PAE dhe 10 PAK (37.5 %; 62.5 % /) 2. Për vitin akademik 2020 – 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 8 PAK (38.% / 62 %); 3. Për vitin akademik 2019 – 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 6 PAE dhe 7 PAK (47 % / 53 %): <table border="1" data-bbox="576 1429 1358 1816"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2019 - 2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>0</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>4</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>6</td> <td>10</td> <td>5</td> <td>8</td> <td>6</td> <td>7</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga përbërja e stafit të tre viteve të fundit akademike vihet re një përbërje e qëndrueshme dhe pothuajse i njëjti raport mes PAE/PAK. Prioritare për departamentit duhet të jetë ndjekja e</p>	Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	1	1	1	1	1	1	Prof.As.Dr	0	3	0	1	0	1	Dr/PhD	1	2	1	3	0	4	Msc	4	4	3	3	5	1	Në total	6	10	5	8	6	7
Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020																																												
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																											
Prof.Dr	1	1	1	1	1	1																																											
Prof.As.Dr	0	3	0	1	0	1																																											
Dr/PhD	1	2	1	3	0	4																																											
Msc	4	4	3	3	5	1																																											
Në total	6	10	5	8	6	7																																											

politikave për rritjen e numrit të studentëve, si dhe atë të stafit të brendshëm me profil Informatikë, ose degë të ngjashme të teknologjisë.

Ndërkohë pasi analizuam informacionin e dhënë në [Ev 51 tab 12], për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2019-2020	1800	1080	720	60% /40%
2020-2021	1680	885	795	53% /47%
2021-2022	1770	945	825	53% /47%

Referuar Curriculum Vitae të anëtarëve të stafit akademik të programit të studimit “Informatikë e Zbatuar”, çdo modul mbulohet nga personel akademik që ka nivelin e duhur akademik me profil studimi në përputhje me fushën kryesore formuese dhe kërkimore të modulit [Ev. Aneks 15].

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Sipas Statutit të KU LOGOS, veprimtaria kërkimore dhe shkencore përbën njëri prej dy shtyllave kryesore mbi të cilat mbështetet misioni i institucionit. Ajo konsiderohet pjesë e pandarë e aktivitetit të përditshëm të stafit të tij akademik duke qenë se arritjet kërkimore dhe shkencore të tij janë të lidhura drejtpërdrejtë me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor dhe me rritjen akademike të stafit të tij në botën e kërkimit shkencor [Ev. Aneks 15].

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e

GVJ konstaton si nga vizita, ashtu dhe nga dokumentacioni i referuar nga RVB, qër për disa arsye, studentët e programit të studimit, pavarësisht dëshirës, planit dhe përpjekjeve të departamentit, nuk ka arritur të realizojë më tepër marrëveshje për praktikant profesional.

GVJ sugjeron që kjo të tejkalohet sa më parë nga IAL, meqënëse krizat e tërmetit dhe pandemisë konsiderohen të tejkaluara.

studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësues shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe Statistikë ka në përbërje stafin ndihmës akademik mësues, i cili ka përgjegjësi të plotë për mbarevatjen e laboratorëve kompjuterikë.</p> <p>Stafi ndihmës akademik ndihmon në mbarevatjen e procesit mësues duke siguruar mjediset laboratorike nga ana teknike si dhe nga ana e mjediseve software të nevojshme.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e	Në lidhje me këtë kriter, GVJ gjen të paraqitur në dokumentin “Për përdorimin e platformës digjitale për mësimin në distancë” metodat që KU LOGOS ka përshtatur për mësimin online. Në këtë document përcaktohen dhe platformat digjitale

<p>metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>për mësimin online sipas departamenteve. Të tilla metoda janë: EduPage, Google Classroom, NeoLMS, Skype. Departamenti i IZS përdor Google Classroom, e nëpërmjet tij stafi akademik krijon mjedise të përshtashme në të cilën hedh të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët si: leksionet, në çdo kohë dhe nga çdo vend [Ev. Aneks 41.4].</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar, si dhe nga takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, konstatohet që Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar dhe zyrtarizuar në Rregullore për sigurimin e cilësisë [Ev. Aneks 7.1].</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, së bashku me departamentin, përgjegjës për programin e studimit Bsc në “Informatikë e Zbatuar”, kryejnë procese kontrolluese të mësimdhënies. KU LOGOS në mënyrë periodike realizon dhe vlerësimin e performancës së pedagogëve në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet dhe FSHA.</p> <p>Një mënyrë e tretë është dhe realizimi i pyetësorëve, të cilët realizohen në fund të çdo semestri me studentët e KU LOGOS.</p> <p>Në pyetësor, studentët pyeten në lidhje me: kushtet e mësimin, bazën didaktike, cilësinë dhe qartësinë e prezantimit të leksioneve e seminareve, korrektesen e mesimit, çështjen e blerjes së teksteve, mitmarrjes, abuzimeve të ndryshme. Përveç vlerësimit të kriterëve të ndryshme të mësimdhënies, studentët kanë dhe të drejta të tjera. Në RVB si dhe në rregulloren e FSHA cilësohen procedurat për përmirësimin e notës, ankimimit të studentëve, e më pas trajtimi i ankimimeve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacioni të dorëzuar nga IAL, konfirmohet rëndësia që i vihet monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në mësimdhënie. Për këtë është ngritur një zyrë e veçantë.</p> <p>Rezultatet e analizës vjetore përmbledhen në një dokument të detajuar, në të cilin përfshihen: Programet e studimit, Procesi mësimor, Stafi akademik, Studentët, Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm. Sipas RVB, rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik. Për kryerjen e vlerësimit përdoren metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, intervistimet anonime</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacioni të dorëzuar nga IAL, konfirmohet rëndësia që i vihet monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në mësimdhënie. Për këtë është ngritur një zyrë e veçantë.</p> <p>Rezultatet e analizës vjetore përmbledhen në një dokument të detajuar, në të cilin përfshihen: Programet e studimit, Procesi mësimor, Stafi akademik, Studentët, Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm. Sipas RVB, rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik. Për kryerjen e vlerësimit përdoren metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, intervistimet anonime</p>

	me shkrim dhe në mjedise auditoresh ballë për ballë, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, punësimin, opinionet e tyre mbi rezultatet e të nxëniet dhe orientimit në tregun e punës, etj. [Ev. Aneks 46.1]			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Një nga arsyet e zhvillimit të pyetsorëve dhe shpërndarjes së rezultateve të tyre tek pedagoget përkatës, është edhe nevoja e përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies, apo të aspekteve të tjera në punë. Gjithashtu, KU LOGOS mbështet dhe promovon stafin akademik për kualifikime për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në bazë të dokumentave të ndryshëm të vënë në dispozicion të GVJ, si dhe nga vizita gjatë institucionit, u konstatua që procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, praktikat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar. GVJ konstaton që format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë sipas kategorive të ndryshme, sic kërkohen në këtë kriter. <i>Detyrat e kursit dhe projektet janë të specifikuar në çdo syllabus, në rastet kur ato janë të planifikuara nga lektori, por në përgjithësi kanë një peshë mjaft të ulët nga gjithë vlerësimi 100% i lëndës.</i> Në kurrikulen e studimeve të programit Informatikë e Zbatuar i është dhënë hapësirë e gjerë si në kredite edhe në kohë praktikës profesionale.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u	Sipas RVB, por edhe në bazë të dokumentacionit të konsultuar, GVJ evidenton që personeli akademik ka respektuar diversitetin e studentëve dhe nevojat e tyre. Metodatat dhe

<p>përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programet e ciklit të parë Bachelor janë të shumëllojshme.</p> <p>Gjithashtu nga RVB, GVJ konstaton që departamenti dhe stafi akademik janë zhvendosur nga forma tradicionale e mësimdhënies në atë bashkëkohore të ndërveprimit. Ata theksojnë që disa nga format e mësimdhënies janë laboratorët, puna në grup, si dhe prezantimet.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, të bibliotekës apo të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave bashkëkohore të të nxënit.</p> <p>Mjetet e ndryshme teknologjike që stafi akademik shfrytëzon për procesin mësimor, janë të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të Curriculum Vitae të dorëzuara nga IAL për anëtarët e stafit që japin mësim në programin Bsc në “Informatikë e Zbatuar”, GVJ arrin në përfundimin që ky personel akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, si pasojë e edukimit të tyre, përvetësimit të titujve dhe gradave apo edhe nga eksperiencia e tyre profesionale në kompani apo projekte IT apo fusha të tjera.</p> <p>Sigurisht që personeli akademik i brëndshëm dhe i jashtëm që angazhohet në mësimdhënie është i diplomuar në fushën përkatëse dhe ka kryer studime të mëtejshme në atë fushë. Në varësi të temës personeli akademik përdor edhe metoda të ndryshme të mësimdhënies të cilat i kemi përmendur më sipër.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>KU LOGOS për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, qofshin efektiv apo me kontratë të pjesshme, plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore, me të cilën GVJ u njoh dhe gjatë vizitës në IAL. Është departamenti ai që formulon kërkesën për ekspertizën e personave në</p>

Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	profesion të specifikuar dhe bën një planifikim paraprak të moduleve që këta pedagogë të rinj do të mbulojnë duke zhvilluar leksionet dhe seminarët. Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që një pjesë e mirë e pedagogëve prezentë në takim përdorin metoda interaktive dhe diskutimi me studentët.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit ndihmojnë në kurajimin e studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve, detyrat e kursit ose projektet lëndore zhvillohen përmes prezantimeve në grup të studentëve. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe aftësitë e punës në grup, si edhe bën që studentët të mësojnë nga njëri-tjetri. Studenti në këto prezantime mund të përfshijë literaturë shtesë si dhe të punojë në mënyrë individuale apo në grup. Nga vizita në IAL në takim me studentët u konstatua një marrëdhënie mjaft e mirë mes tyre me njëri-tjetrin e mbi të gjitha kundrejt stafit akademik. U vu re respekti i ndërsjellë, ku studentët u shprehën që për çdo çështje apo problematikë në universitet që ata mund të kishin pasur, u ishin drejtuar pa problem stafit dhe kishin gjetur zgjidhjen ose mire-kuptimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesisë dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Gjatë vizitës në institucion, në bazë të RVB, si dhe duke shqyrtuar dokumentacionin, GVJ konkludon që procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. Në bazë të vizitës dhe RVB ambjentet e KU LOGOS janë të pastra si rrjedhojë e punës që bëhet nga stafi i punësuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve të institucionit. Ky IAL ofron mjedise të reja e të pajisur plotësisht me të gjithë kapacitetin infrastrukturor dhe teknologjik për të plotësuar kërkesat e programit të studimit si dhe në përputhje me qëllimet e programit. I tërë procesi mësimor i programit të studimeve Bachelor në Informatikë e Zbatuar, zhvillohet në ambjentet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara. Për laboratorët kujdeset stafi ndihmës. Të gjitha
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	


	sallat ku zhvillohen leksionet janë të pajisura me videoprojektorë.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Në bazë të dokumentacionit, institucioni ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Përmendim Google Classroom, që më së shumti u përdor gjatë pandemisë, si dhe Microsoft Teams për në vazhdim.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Në syllabuset e lëndëve vendoset literature bazë dhe ajo e rekomanduar, të cilat shpesh janë të alternuara mes burimeve fizike dhe atyre elektronike. Në orën e parë të leksionit për çdo modul që zhvillohet në degën Informatikë e Zbatuar pedagogu përkatës i informon studentëve literaturën bazë dhe ndihmëse që do të përdoret për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Këto materiale janë në formë elektronike ose të printuara.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka shkencore e KU LOGOS është pjesë e rëndësishme jo vetëm e ambjenteve të studentëve, por edhe si një burim i rëndësishëm Informacioni. Cilësojmë që IAL e ka shtuar pothuajse çdo vit numri i titujve të saj, në të tre gjuhët: shqip, anglisht dhe greqisht. Edhe pse titujt janë të autorëve më në zë të fushës, përsëri sugjerojmë marrjen e botimeve të reja, në mënyrë që Informacioni në to të jetë sa më aktual. Pavarësisht kësaj, IAL ka garantuar akses në bibliotekat online si JSTOR dhe EBSCO, duke plotësuar kështu nevojat e kërkuesve dhe studentëve. Me vendosjen e Bibliotekës Dixhitale të mundësuar nga RASH studentët do të kenë mundësi të aksesojnë literaturën ndihmëse që ju është dhënë për referencë dhe thellim të njohurive nga pedagogu i modulit përkatës dhe gjithashtu për zhvillimin e temave të diplomave. Kjo literaturë synon të jetë bashkëkohore dhe të përmbajë titujt më me zë të fushave që ndërthuren në programin e studimit Bsc në Informatikë e Zbatuar.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe	Gjatë vizitës në IAL u konstatuan ambjentet e mirëmenaxhuara dhe të plotësuara me infrastrukturën dhe teknologjinë e duhur për zhvillimin e laboratoreve dhe

studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	seminareve të lëndëve të IT. Ato, bashkë me ambjentet e Bibliotekës shfrytëzohen nga studentët sipas nevojave të tyre.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	IAL disponon një platformë për mësimin online, Microsoft Teams, kontrata e të cilëve është 1-vjecare dhe e rinovueshme. Secili pedagog ka llogarinë e vet ku ai mund të informojë studentët e tij në lidhje me orët e mësimin apo materiale të ndryshme që ata të mund të shkarkojnë nga site i pedagogut. Komunikime të brendshme mund të realizohen po nëpërmjet këtyre platformave, ashtu si dhe me anë të postës elektronike.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.				
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Realizimi i temave të diplomave si përmbyllje e këtij cikli studimi vendoset në bazë të dokumentit “Rregullore e programit të studimit” po ashtu dhe të departamentit, sipas të cilit studentët me mesatare mbi 8.5 mund të zgjedhin një temë. Të tjerët do të duhet të kenë një provim final formues me të gjithë temat kryesore të programit Bachelor. Që në fillim studentët që aplikojnë për temë diplome dhe që plotësojnë kriterin përkatës komunikojnë me pedagogun udhëheqës i cili i orienton studentët për të zgjedhur temën e përshtatshme. Më vonë studenti dhe pedagogu udhëheqës gjatë gjithë kohës bashkëpunojnë për ta përmirësuar hap pas hapi zhvillimin e temës deri në finalizimin me sukses të saj [Ev. Aneks 50; Aneks 40.4; Aneks 40.5].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të KU Logos / Fakulteteve / departamenteve / programeve të studimit, të cilat janë në funksion të organizimit të mësimdhënies në programe të ndryshme studimi. Njësia kryesore që asiston në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor është NJSBC. Kjo njësi harton plan pune bazuar në rregulloret e funksionimit të saj. NJSBC-ja harton raporte vjetore që janë detyrim institucional. Raportet e NJSBC shërbejnë si shtysë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.. [Ev. Aneks 4]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Informatikë e Zbatuar dhe Statistikës, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, është përgjegjëse për programin e studimit “Informatikë e Zbatuar”. Ai kujdeset për cilësinë e mësimdhënies, përzgjedh personelin akademik, si dhe bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me rregullatorët e institucionit si dhe bazuar në ligjet e arsimit të lartë. Departamenti përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes si të pedagogëve ashtu dhe të studentëve që programi i studimit Bsc në Informatikë e Zbatuar është një program bashkëkohor, madje rëndësinë e këtij programi studimi e kanë shprehur në disa raste dhe analiza në dokumentacionin e dorëzuar, si një drejtim i rëndësishëm dhe i kërkuar dhe studentët dhe tregu i punës [Ev. Aneks 4; Aneks 7.1].</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Njësia kryesore ku zhvillohet ky program studimi mbështet dhe nxit pedagogët të përdorin metodave inovative dhe alternative në procesin e mësimdhënies. Institucioni ka mbështetur fort aplikimin e metodave të mësimdhënies online përmes trajnimit të stafit akademik si dhe përmes investimit në këto platforma. Struktura e ngritur me anë të Teams është një prej tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti ndjek politika lehtësuese për kërkimin shkencor të personelit i cili konsiderohet një aset thelbësor. GVJ konstaton që KU LOGOS nxit pjesëmarrjen e pedagogëve në trajnime qe zhvillojnë aftësitë e tyre. Ky IAL ka organizuar konferenca</p> <p>Nga ana e tyre stafi është mjaft i interesuar për të marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare si dhe në trajnime jashtë vendit për të përmirësuar fushën e tyre të kërkimit e për</p>




<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>ta pasqyruar këtë dhe në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në këto projekte ka pasur impakt dhe zhvillimi i vetë degës “Informatikë e Zbatuar”, pasi janë vendosur dhe ura të rëndësishme bashkëpunimi si dhe është zgjeruar rrjeti akademik, që mund të sjellë përfitime të tjera në të ardhmen.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Në KU LOGOS përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie mbetet përgjegjësi individuale e personelit akademik. Institucioni bën përpjekje për të promovuar përdorimin e këtyre metodave,</p> <p>Në programin e studimit “Informatikë e Zbatuar”, pjesa më e madhe e stafit u vu re që janë të rinj dhe puna e bërë prej tyre për ndërtimin dhe përdorimin e mëtejshëm të faqeve web dhe sistemeve të tjera mbështetëse është e rëndësishme për programin.</p> <p>Në Departamentin e programit të studimit përdoren mjete audio-vizive; ndërthuret teoria e përçarur me shembuj të botës reale për të rritur nivelin e asimilimit; nxitja e ideve nëpërmjet punës në grup etj.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitet përgjegjëse.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen</p>	<p>Në lidhje me kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, IAL ka të përcaktuara në dokumentin “Rregullore e Programit të</p>

në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Studimit” si dhe në syllabuset e lëndëve [Ev. Aneks 6; Aneks 11.2].			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në Rregullore, Neni 16 përcaktohen procedurat e kriteret e vlerësimit. Ato vendosen në syllabus dhe u kalohen më pas studentëve. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet me shkrim, me gojë, i kombinuar, ose me detyra kursi, projekte, ose raporte. Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të Fakultetit, të programit si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ vlerëson që të gjitha format e vlerësimit të njohurive të përmendura në kriterin 1 dhe 2 i japin mundësi studentit që të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. [Ev. Aneks 6; Aneks 11.2] Gjatë gjithë vitit ata janë në një proces të pandërprerë të mësuarit dhe vlerësimit nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, rasteve të studimit etj. <i>GVJ sugjeron që këto masa vlerësimi të mos jenë të njëjta për të tre vitet akademike. Gjatë vitit të parë të studimeve pesha e provimit përfundimtar mund të mbetet në masën 70-80%, ndërsa në vit të tretë, ku detyrat dhe projektet janë më komplekse, pesha e tyre të jetë rreth 50-60%.</i> <i>Së dyti, sugjerohet që detyrat e kursit në ndonjë prej lëndëve të jenë në formën e “short paper”, në mënyrë që studentët të trajnohen me mënyrën e të bërit kërkim shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Sipas të dhënave të reflektuara në syllabus-et e lëndëve, e në bazë të Rregullores të Programit të studimit, vlerësimi i

<p>profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>përgatitjes akademike të studentit është shumë e elementëve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> Provimit të ndërmjetëm Nivelit të diskutimit në seminare Detyrës së kursit/detyra praktike Provimit përfundimtar. <p>Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në mes të semestrit (java e 7-të ose e 8-të, sipas Rregullores, seminarët janë të përjavshme, kurse detyrat e tjera janë të shpërndara sipas planit të secilit pedagog të lëndës. Kjo, për GVJ, vërteton shpërndarjen e vlerësimit përgjatë gjithë semestrit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sipas RVB, në programin e studimit të Informatikë e Zbatuar pedagogët janë të udhëzuar të përdorin mjete teknologjike si DupliChecker, Plagiarisma, etj, për origjinalitetin e një detyre kursi.</p> <p>Për testimin dhe vlerësimin, konstatohet që nuk ka.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (“Rregullore e programit të studimit”), si dhe RVB, çdo komision përbëhet nga dy pedagogë njëri prej të cilëve është titullari i lëndës dhe pedagogu tjetër është pedagog që zhvillon module të ngjashme apo dhe mund të ndajë me pedagogun përgjegjës së lëndës pjesën e zhvillimit të seminareve.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Sipas RVB, KU LOGOS ka një format të vetin të fletoreve ku mund të realizohet sekretimi nga sekretarja e departamentit dhe mos njohja e identitetit të studentit.</p> <p>Në momentin që studentit i sekretohet fletorja i vendoset një numër në kapak dhe ai e di se fletorja e tij/saj mban këtë numër.</p> <p>IAL nuk siguron infrastrukturë të posaçme dhe mjete survejimi në provimet e lëndëve të programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, në takim me studentët, u konstatua që studentët kanë marrë komente dhe janë sqaruar në rastet kur nuk kanë pasur qartësi për pjesën e korrigjimit të provimeve. Komentet vendosen dhe në fletoret e studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili,</p>	

nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.									
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në programet lëndore (syllabus) të programit të studimit “Informatikë e Zbatuar” nuk cilësohet në përgjithësi se çfarë penaltetesh mund të ketë një student që konstatohet se ka bërë plagjiaturë në detyrën e kursit /projektit/provimit. Mënyra e zhvillimit të provimeve saktëson që studentët duhet të hyjnë me mjet identifikimi dhe nuk lejohen të kopjojnë, tezat rifreskohen në çdo sezon provimesh, si dhe për tezat e diplomave nuk lejohet plagjiatura. Por, IAL nuk shpjegon se si mundet që pedagogët udhëheqës të zbulojnë plagjiaturën.								
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në dokumentin “Rregullore e KU Logos”, studentët mund të hyjnë në provim vetëm pasi konfirmohet nga pedagogu shlyerja e detyrimeve semestrare. Ky proces forcon pjesëmarrjen dhe meritokracinë e vlerësimit. Sipas kësaj Rregullore studenti njihet me rezultatet brenda 5 ditëve nga data e provimit. Studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin e tyre, gabimet, apo cdo paqartësi tjetër nga pedagogu i lëndës.								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.									
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ konstaton që procedura e ankimeve të studentëve është e dokumentuar dhe nëse një student që gjykon se ndaj tij ka pasur shkelje proceduriale në vlerësim, i drejtohet një Komisioni me 3-5 anëtarë i cili monitoron dhe menaxhon të gjitha të dhëna për realizimin e suksesshëm të provimit. Ky komision merr vendimet për cdo ankesë dhe i arkivon ato. [Ev. Aneks 40.10]								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Informatikë e Zbatuar”, sipas dokumentit “Rregullore e Programit të studimit”, Kreu I, Neni 1, <i>synon të përgatisë specialist të aftë për zgjidhjen e problemeve teknike në fushat informatikës dhe programimit, rrjetave, etj.</i> GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, por GVJ sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhornimin e literaturave, si dhe shtimin/modifikimin e lëndëve të caktuara, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në programin e studimit “Informatikë e Zbatuar” rreth 55% të lëndëve të kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit. Përveç këtyre kemi dhe lëndë plotësuese si është Gjuha e Huaj Anglisht, dhe Greqisht, literaturat plotësuese të lëndëve janë pjesa më e madhe në anglisht (nga vetë natyra e programit të studimit në fushën e informatikës), por nuk ka lëndë që jepen në gjuhë të huaj.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në programin e studimit, për secilin modul të programit të studimit gjendet rubrika Përmbledhje dhe Rezultate e të Nxënit. Në përfundim të modulit stafi akademik bën një vlerësimin të nivelit të përfitimit të kompetencave të synuara në syllabusin e modulit. Njësia kryesore dhe njësia bazë organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde pedagogu i modulit bën një përmbledhje të çështjeve më të rëndësishme duke i orientuar në lidhje me provimin përfundimtar, zbatimin e tyre në praktikë si dhe sjell raste studimi nga eksperiencia e tij të viteve të kaluara. Një pjesë e mirë e syllabuseve dhe planeve kalendar të moduleve kanë të parashikuara seanca speciale për përsëritjen e lëndës, pra evidentimin e temave më të rëndësishme mesqarimet e nevojshme. Departamenti garanton realizimin e këtij procesi nëpërmjet anketave të vazhdueshme me studentët.</p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Përgjithësisht personeli akademik i brendshëm integron të rejat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në programin e studimit "Informatikë e Zbatuar", përveç leksioneve janë dhe seminarët të cilat aplikojnë çdo njohuri të marrë në leksione duke i zbatuar ato me përdorimin e softuerëve që ndodhen të instaluar në laboratorët e programit të studimit. Gjithashtu, për t'i dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë më shumë njohuritë e tyre në praktikë kurikula e programit të studimit Informatikë e Zbatuar është ndryshuar, duke e përmirësuar ndjeshëm cilësinë e saj.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, në takimin me stafin GVJ konstatoi mirëkuptimin dhe dëshirën e stafit për të zhvilluar më tej programin e studimit. Në këtë takim morën pjesë pothuajse pjesa më e madhe e stafit akademik.</p> <p>Të gjithë anëtarët e DIZS i diskutojnë çështjet që lidhen me programin e studimit Informatikë e Zbatuar dhe më pas në nivel departamenti dhe për programet e tjera ku ata janë të angazhuar për të dhënë mësim. Gjithashtu anëtarët e departamentit DIZS bashkëpunojnë dhe me anëtarët e departamenteve të tjera që zhvillojnë mësim në programin e studimit IZ. Nga ana tjetër pedagogët e DIZS diskutojnë dhe bashkëpunojnë me sektorin e IT-së për mirëfunksionimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe rrjetit përkatës (p.sh formatimi dhe gjetja e softëare-eve të ndryshme si paketa Microsoft Office, Windows 10, etj).</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Në programet lëndëve GVJ konstatojnë që në shumicën e lëndëve studentët zhvillojnë projekte kurse dhe detyra kurse. Projektet dhe detyrat e kursit përfshihen dhe në vlerësimin e vazhduar të studentit, kështu që kjo përveçse i ndihmon studentët për të rritur frymën e bashkëpunimit në grup dhe për të marrë njohuri më të thella lidhur me lëndë të caktuara i ndihmon ata edhe për një vlerësim më të plotë të lëndës përkatëse. GVJ mendon që për të zhvilluar idetë inovative, për të kryer studime të avancuara kërkimore e shkencore detyrat e kursit nuk mund t'i plotësojnë mjaftueshëm këto aftësi. Në rastin më të mirë, këto aftësi plotësohen duke përfshirë stafin dhe studentët në projekte kërkimore.</p>

	Një formë tjetër mund të jetë duke kërkuar financime nga Alumni, ose nga biznese që FSHA/DIZS ka marrëveshje për të financuar sadopak projekte, iniciativa, pajisje të vogla (sensorë, aparatë matës, pajisje rrjeti, nyjë përpunuese, etj).			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	GVJ nuk konstaton ndonjë formë tjetër mbështetjeje financiare, por FSHA organizon konferenca studentore të përvitshme.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Sikurse është përmendur në kriteret e mësipërme që lidhen me kualifikimin e stafit, një pjesë e tyre janë trajnuar jashtë vendit për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të. Gjithashtu programet e studimit në FSHA janë të unifikuar me programet e universiteteve partnere në mënyrë që studentët të shkëmbejnë eksperiencë me homologët e tyre, veçanërisht në Greqi			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në dokumentin “Rregullore e Brendshme” janë të hartuara dhe përcaktuara procedurat e posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës. Ky dokument është bërë publik në faqen zyrtare të fakultetit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të	Departamenti vë në dispozicion të studentëve formatin e Diplomës (sipas dokumentit të dorëzuar), në të cilin janë të përcaktuara jo vetëm rregulla të formatimit të tekstit, por ka dhe instruksione për përmbajtjen, çështjet kryesore që duhet të mbajë tema, hipotezat, referencat etj.

provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	GVJ konstaton që kjo është një ndihmë e rëndësishme që u jepet studentëve, por theksojmë sërish që për procesin e shkrimit të një punimi shkencor/diplome ata duhet të jenë instruktuar në një lëndë të veçantë ose në përbërje të ndonjë lënde ekzistuese, sic kemi sugjeruar, Shkrim Akademik në vend të Përpunim Teksti.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studentët me mesatare nën 8.5 zhvillojnë provim të përgjithshëm, të cilëve u vihet në dispozicion një listë me pyetje/ushtrime. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Diploma ose provimi final zhvillohen në semestrin e gjashtë dhe kanë 6 ECTS
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Në bazë të dokumentit “Rregullore e brendshme e departamentit”, temat e diplomave udhëhiqen nga stafi mësimor-shkencor që kanë titull ose gradë shkencore, apo nga punonjës të tjerë shkencorë të FSHA. GVJ konkludon që orientimi dhe ndihma e personelit akademik për studentët në përgatitjen e temës së diplomës realizohet nëpërmjet konsultimit, në rastet kur studenti ka nevojë.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në rastin e punimit të diplomës në programin e studimit bachelor në Informatikë e Zbatuar institucioni i asiston studentët duke ju vendosur në dispozicion laboratorët dhe gjithë mjediset e FSHA dhe jashtë orarit zyrtar të mësimin. Studentët mund të shfrytëzojnë kompjuterat dhe programet e instaluar në rastet kur nuk janë të pajisur me laptop personal. Në këtë kriter kërkohet dhe asistencë e IAL për kryerjen e matjeve e analizave, pra procedurave eksperimentale. GVJ rithekson nevojën që ka ky program studimi veçanërisht për zhvillimin e këtyre proceseve, shumë më tepër se programe të tjera të ngjashme studimi në IAL shqiptare.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i	Në departamentin e Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës, udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Studenti në fund të provimit, ose të mbrojtjes së diplomës vlerësohet me notë.

plotë për t'u paraqitur para komisionit.				
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.				
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sipas dokumentit “Rregullore e brendshme e departamentit, studenti që kalon me sukses temën e diplomës/provimin e formimit pajiset me diplomën përkatëse, e cila i jepet atij së bashku me “Shtojcën e diplomës” (diploma supplement). Në dokumentin e diplomës shënohet fusha e studimit të përfunduar dhe specialiteti përkatës.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Në raste të tilla studentët depozitojnë pranë sekretarisë një kërkesë dhe brenda një afati të caktuar u jepet një kopje e firmosur dhe vulosur e programit të ciklit të studimit Bachelor në Informatikë e Zbatuar.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor rregjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (“Rregullore e brendshme e departamentit”).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe aDIZSnistrativ.</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos” mbështet veprimtarinë e tij përmes angazhimit të një stafi akademik dhe person ndihmës dhe administrative cilësor. Politikat e rekrutimit janë përcaktuar qartë në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe në Statut të Institucionit [Ev:Aneks 5: Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara; Aneks 1: Statuti I Kolegjit Universitar – 2017 Mars].</p> <p>Në strukturën organizative të KU Logos është e përfshirë edhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arkivës [Ev: Aneks 1: Statuti I Kolegjit Universitar – 2017 Mars, Kreu II, neni7].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>KU Logos zbaton nje procedurë të qartë rekrutimi. Institucioni ka hartuar edhe dokumentin “Politika dhe Procedura të Burimeve Njerëzore në Kolegjin Universitar “Logos”” i cili shërben edhe si udhëzues për zbatimin me korrektësi të procedurave të rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë, stafin akademik të ftuar, personelin ndihmës – akademik dhe administrativ [Ev: Aneks 9]. Politikat e punësimit në Kolegjin Universitar “Logos” mbështeten dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Kriteret e punësimit janë të shprehur qartë në nenin 24 të Statutit të Institucionit. Kërkesat për staf akademik burojnë nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori. Përzgjedhja e kandidatit drejtohet nga një komision adhoc i përbërë me shumicë nga njësia bazë [Ev:Aneks 1: Statuti I Kolegjit Universitar – 2017 Mars, Kreu II, neni 24]. Vendimin për emërimin e merr Bordi Drejtues i Fondacionit Themelues të Kolegjit Universitar “Logos”.</p>

	<p>Procedurat e rekrutimit kryhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arkivës. GVJ konstaton se thirrjet janë transparente dhe publikohen edhe në website [http://www.kulologs.edu.al/al/punesimi.html].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konstaton se në drejtim të rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, institucioni zhvillon një praktikë korrekte në përputhje me rregulloren për punësimin. Rregullorja në lidhje me politikën dhe procedurat e burimeve njerëzore në KU “Logos” përcakton qartë në nenin 1 (Rekrutimi) kriteret e përgjithshme që çdo kandidat duhet të plotësojë ndërsa kriteret e veçanta përcaktohen nga drejtuesi i njësisë bazë [Ev: Aneks 9]. Ndër kriteret e përgjithshme vlen të përmenden:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kandidati duhet të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron; 2. Të jetë i aftë të garantojë standartin e cilësisë në mësimdhënie; 3. Të ketë aftësi të punës në grup dhe një komunikim profesional me kolegët dhe studentët; 4. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore; 5. Të mos jetë i dënuar në vendim të formës së prerë nga Gjykata për kryerjen e veprave penale dhe të mos jetë person në hetim; <p>GVJ u njoh me praktika të kryera në lidhje me punësim të stafit akademik me kohë të plotë dhe të ftuar. GVJ evidenton si kritere të veçanta në procedurat e rekrutimit për stafin akademik si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kandidati duhet të jetë i diplomuar në fushën e Teknologjisë së Informacionit ose në fusha të tjera të ngjashme me të; 2. Të zotërojë të mbrojtur me dëshmi gjuhën angleze; 3. Të zotërojë të paktën gradën shkencore “Master i Shkencave” ndërsa përbën avantazh zotërimi i gradës “Doktori i Shkencave”; 4. Të zotërojë mesataren mbi 8.5; 5. Të ketë përvojë në fushën akademike dhe profesionale brenda dhe/ose jashtë vendit; <p>Njoftimi për vendet vakante e shoqëruar me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta shpallet në website: www.kulogos.edu.al/vendepune ku gjithashtu mund të shkarkohet edhe formulari i kërkesës që secili kandidat duhet të plotësojë [Ev: aneks 13.5]</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedurë rekrutimi dhe vlerësimi bazuar në Rregulloren e Politikave dhe Procedurave të Burimeve Njerëzore dhe në Statut të KU “Logos” [Ev: aneks 9; aneks 1].</p> <p>Miratimi për shpalljen e konkursit për vendet e lira të punës për personel akademik me kohë të plote bëhet nga Administratoi në përputhje me vendimin e Rektorit. Vendimi i marrë nga Administratoi shoqërohet edhe me informacionin në lidhje me dokumentacionin që çdo kandidat duhet të ketë në tre fazat:</p> <ol style="list-style-type: none"> Faza e aplikimit; Faza e paraqitjes për intervistë; Faza e shpalljes fitues; <p>Drejtorja e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për procedurën e konkurrimit. Përzgjedhja e kandidatëve fitues bëhet përmes konkurrimit me dosje dhe me intervistë. Për procedurat e konkurrimit ngrihet një komision ad-hoc. GVJ konstaton nga procedurat e paraqitura nga institucioni në përbërjen e ad-hoc dominojnë 3 anëtarë: Dekani, Drejtuesi i njësisë bazë dhe një përfaqësues i Administratës sipas propozimit nga Administratoi (kryesisht përfaqësues i sektorit të burimeve njerëzore).</p> <p>Çdo anëtar i komisionit ad-hoc vlerëson dosjet e kandidatëve në fazën e aplikimit dhe vlerëson me pikë në fazën e intervistës. Njoftimi për intervistën dhe rezultatet e konkurrimit bëhet përmes e-mail-it zyrtar të KU “Logos” në adresën elektronike të kandidatit. Kandidati vihet në dijeni edhe për afatin e ankimit i cili mund të bëhet dy ditë pas shpalljes së rezultatit [Ev: aneks 9; aneks 13.5].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të</p>	<p>KU “Logos” i kushton një vëmendje zhvillimit të infrastrukturës. Objektivi dy: Organizimi dhe qeverisja faktike e shprehur në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit (2018-2024) ofron si plan veprimi zhvillimin e infrastrukturës</p>

<p>barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>[Ev:aneks 2]. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ofron një mjedis i cili garanton cilësinë në mësimdhënie. Infrastruktura siguron një mjedis të duhur edhe për stafin akademik për të zhvilluar punën e tij kërkimore dhe shkencore. Për Departamentin e Informatikës së Zbatuar & Statistikës janë vënë në dispozicion një sipërfaqje 45.25m² me nje norme 9m²/person [Ev: aneks 51 tabela 16].</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton akomodimin e stafit akademik në zyra në përputhje me standartet dhe konform ruajtjes së një hapësire të duhur dhe të nevojshme për secilin pedagog për të zhvilluar veprimtarinë tij. Sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët janë të pajisur me mjetet e duhur didaktike. Laboratorët janë të pajisur me mjetet e duhur didaktike duke krijuar një mjedis me cilësi në mësimdhënie. Infermiera është e pranishme për të dhënë ndihmën e parë kundrejt studentëve dhe stafit në rast nevojë. Salla e konferencës e vendosur në katin e parë mundëson zhvillimin e leksioneve të hapura, konferenca të stafit akademik dhe studentëve. Mjediset rekreative për studentët dhe punonjësit (palester, bar) janë të pranishme [Ev: takim në institucion].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe aDIZSnistron programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës i kushton një vëmendje të veçantë kualifikimit të stafit akademik.</p> <p>Konkretisht për vitin 2021-2022 ky department ka angazhuar staf akademik efektiv dhe të ftuar si vijon: 1 Prof.Dr, 1 Dr, dhe 4 MSc kundrejt 10 PAK (1 Prof. Dr. 3 Prof. Assoc. Dr, 2 Dr., dhe 4 MSc) me një raport në përqindje 37 % PAE kundrejt 63% PAK [Ev: aneks 15].</p> <p>DIZS zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në një strategji afatshkurtër (një – vjeçare), afatmesëm (dy vjeçare) dhe afatgjatë (5 vjeçare) në përputhje edhe me gjashtë kolonat kryesore të strategjisë së institucionit [Ev: 51tab 2;]. GVJ konstaton se kualifikimi i stafit akademik përbën një nga objektivat kryesore të njësisë baze.Synimi kryesor është rritja në masën 70% të stafit akademik me grada shkencore. Në këtë drejtim pezullimi i shkollës së doktoraturës për një periudhë 4 – vjeçare e cila në analizen SWOT të njësisë bazë është konsideruar edhe si një dobësi ka penalizuar pak stafin akademik në drejtim të kualifikimit të tyre akademik. GVJ konstaton se politikat e motivimit, shpërblimit dhe zhvillimi i trajnimeve kundrejt stafit akademik të shprehur qartë në dokumentin “Rregullore për politikat dhe veprimtarinë e burimeve njerëzore” zbatohen me korrektësi. Takimi i zhvilluar me stafin akademik elaboroi shembuj të mbështetjes financiare dhe në lirinë akademike që stafi kishte për</p>

	kualifikimin e tij profesional [<i>Ev: aneks 13.2.5; takim ne institucion</i>].
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara i kushton një vëmendje të veçantë përmirësimit të metodave të mësimdhënies.</p> <p>Në këtë drejtim GVJ konstaton trajnime të kryer si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajnim për platformën Microsoft office 365 e zhvilluar gjatë periudhës së covid-19; 2. Trajnime të kryera nga kompania Helius Systems; 3. Trajnime në kuadër të bashkepunimit me Universitetin e Pireus-it; 4. Mobiliteti i stafit akademik në universitetin e Pireus ka reflektuar edhe në një rritje të cilësisë së mësimdhënies; <p>[<i>Ev:Takime në institucion; aneks 27.1</i>]</p>
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës zotëron një staf akademik me eksperiencë dhe përvojë në fushën e programi të studimit Bachelor në “Informatikë e Zbatuar”. Nga dokumentacioni i paraqitur nga institucioni dhe nga takimet e zhvilluar me stafin akademik dhe autoritetet drejtuese GVJ konstaton se numri i stafit akademik nuk ka pësuar ndryshime evidente përgjate periudhës 2019-2022.</p> <p>Referuar rekomandimit të dhënë në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit nr.49 datë 05.07.2019 “Për Akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Informatikë e Zbatuar””: “...<i>Institucioni duhet të rekrutojë staf të ri akademik efektiv, me grada dhe tituj, me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore nga staf akademik efektiv në masën 70% dhe uljen e ngarkesës së lartë mësimore të stafit akademik efektiv aktual të angazhuar në këtë program studimi</i>” konkludojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucioni ka reflektuar për të ulur ngarkesën mësimore të stafit akademik efektiv bazuar edhe në plan veprimin për përmbushjen e rekomandimit të dhënë nga Bordi i Akreditimit. Gjatë vitit akademik 2019-2020 konstatojmë një mbingarkesë të stafit akademik me gradën shkencore Dr në proces dhe MSc. Ndonëse ngarkesa mësimore është brenda normës së përcaktuar nga korniza ligjore, numri i lëndëve që mbulohen është i madh. Shembull japim për tre pedagogët me graden MSc të cilat mbulojnë secila 5 lënde në programin e studimit, pedagogu me graden Dr në proces e cila mbulon 6 lëndë duke sjelle edhe një mbingarkesë në përgatitjen profesionale dhe kufizuar hapësirën kohore për

punën e tyre në drejtim të aftësisimit shkencor. Per vitin akademik 2020 – 2021 dhe 2021 – 2022 si pasojë e rekrutimit të një pedagogu me gradën shkencore Dr ngarkesa mësimore është shpërndarë më drejt. GVJ evidenton një reduktim të numrit të lëndëve që pedagogoet me gradën MSc mbulojnë (per stafin me gradën MSc ngarkesa është reduktuar në 3 deri në 4 lëndë ndërsa për stafin akademik me gradën Dr. në proces është reduktuar në 4 lëndë).

- GVJ konstaton një rritje të stafit PAK përgjatë periudhës 2020-2022 duke sjellë edhe një rritje të cilësisë së mësimdhënies.

Nga evidentimi i bërë për ngarkesën mësimore, konstatohet:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2019-2020	1800	1080	720	60%/40%
2020-2021	1680	885	795	53%/47%
2021-2022	1770	945	825	53%/47%

Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe të Departamentit të Informatikës së Zbatuar & Statistikës ku synohet në hapjen e një masteri profesional, *GVJ sugjeron rritjen e stafit akademik efektiv e cila do të sjellë lehtësimin e punës shkencore të stafit në drejtim të plotësimit të objektivit të tyre me grada shkencore dhe forcimin e kapaciteteve për përbushjen e objektivave aftgjatë të njësisë bazë.*

[Ev: aneks 3; aneks 17]

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë infrastrukturës për të garantuar zhvillimin cilësor të mësimdhënies dhe në përmbushje të standardeve në fuqi. Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, GVJ konfirmon se KU “Logos” disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Programi i studimit Bachelor në “Informatikë e Zbatuar” zhvillohet në godinen nr.1 e pozicionuar në qendër të Tiranës. Godina është në gjendje të mirë dhe e mirëmbajtur. Gjithashtu, baza laboratorike informatike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të moduleve që ndërtojnë këtë program studimi. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset në të cilat zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit përmbushin më së miri standartet dhe janë në raport të drejtë me numrin e stafit akademik dhe të studentëve të programit. Auditorët, zyrat, laboratorët janë të ndriçuara drejt dhe të pajisura me të gjithë mjetet didaktike që mundësojnë një zhvillim normal të procesit mësimor. Hapesira rekreative janë të pranishme. Sallat dhe laboratorët janë të pajisur me të gjithë mjetet didaktike duke siguruar një cilësi në mësimdhënie. Numri i ulët i studentëve krijon lehtësi të shfrytëzimit të laboratorëve edhe pas orëve të mësimi. Infermiera është në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik. Institucioni ka vendosur në çdo kat plan evakuimin e shoqëruar edhe me bombolat antizjarr në rast emergjence duke garantuar sigurinë e personelit dhe studentëve në mjediset e tij. Për të ndihmuar në sigurimin e një mjedisi të sigurt fizik është instaluar një sistem survejimi CCTV ku menaxhimi dhe përdorimi i saj kryhet bazuar në rregulloren e miratuar nga ADIZSnistratori i KU “Logos” .</p> <p><i>[Ev. Vizita në institucion; RVB; aneks 51 tabela 16; aneks 36.3; aneks 30; aneks 30.1; aneks 30.2; aneks 30.3; aneks 30.4; aneks 30.5; aneks 30.6; aneks 30.7; aneks 30.8; aneks 30.9; aneks 30.10; aneks 30.12; aneks 30.13]</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit</p>	<p>Mjediset e sallave të leksioneve dhe seminareve (4 salla leksioni dhe 3 salla për seminare) dedikuar Departamentit të Informatikës së Zbatuar & Statistikës janë të pajisura me të gjithë mjetet në ndihmë të zhvillimit të procesit mësimor. Nga vizita në institucion gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion</p>

<p>mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>të realizimit të këtij programi studimi. Norma është 10.8m²/student [Ev: aneks 51. Tabela 16].</p> <p>Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës në raportet e tij vjetore konsideron përmirësimin e infrastrukturës si një faktor i rëndësishëm. Përmirësimi i laboratorëve është reflektuar si çështje edhe në Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit të Informatikës së Zbatuar & Statistikës në përputhje me objektivin në drejtim të hapjes së Master Profesional në fushën e Informatikës [Ev: aneks 3].</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës ka vënë në dispozicion të programit mësimor 3 laboratorë të informatikës me një total 45 kompjutera. Sallat e laboratorëve janë të pajisur me të gjithë mjetet didaktike për të zhvilluar me cilësi procesin mësimor [Ev: Aneks 30.2; aneks 51; Tabela 16, vizitë në institucion; RVB].</p> <p>Infrastruktura informatike është e mbështetur dhe nga sisteme shfrytëzimi dhe programe kompjuterike që i korrespondojnë nivelit të kërkuar të formimit Bachelor. Laboratorët janë në dispozicion të studentëve jo vetëm gjatë procesit mësimor por edhe jashtë saj. Në mbështetje të programit për orët laboratorike dhe për punën studimore të studentëve është edhe zyra e IT [Ev: takim me stafin akademik, vizite në institucion].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Për vetë natyrën e programit të studimit, mbështetja për realizimin e tij janë laboratorët e informatikës, të cilët janë të paisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës [Ev. Vizita e ambienteve; RVB].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Heliuss System e cila e vendosur në katet e sipërme të godinës krijon facilitet për studentët të kryejnë praktikën mësimore por edhe të shfrytëzojnë bazën laboratorike. Kjo kompani ka investuar edhe në bazën laboratorike duke rritur cilësinë e tyre në drejtim të mësimdhënies [Ev: aneks 23; aneks 23.4; takim me stafin akademik].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara pjesë e të cilës është edhe Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës vë në dispozicion të studentëve në këtë program studimi bibliotekën. Kjo strukturë funksionon mbi bazën e një Rregullore të Brendshme të miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.11 datë 13.02.2019 [Ev:aneks 33.1]. Biblioteka është e pozicionuar në katin e tretë në një shtrirje të gjerë (173m ²) është vënë në shërbim të procesit mësimor dhe formimit profesional të studenteve [Ev: aneks 53.1 tabela 16]. Në këtë strukturë janë punësuar një staf me eksperiencë dhe e dedikuar 3 bibliotekare [Ev: vizitë në institucion]. Biblioteka është në dispozicion të studentëve edhe për këtë program studimi përmes ofrimit të një numri të mjaftueshëm botimesh dhe vende për studim.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka zotëron një fond të gjerë botimesh. Ky sektor ka 181 libra në total (84 në gjuhën shqipe, 67 në greqisht dhe 30 në anglisht) si edhe 140 tituj (45 në shqip, 65 në greqisht dhe 30 në anglisht). Studentët kanë akses në revisten “Monitor” dhe në arkiven Monitor (www.monitor.al) [Ev:aneks 33.2, aneks 33.3].
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në	Biblioteka ka 45 poste studimi në fondin e hapur të librit për të cilën edhe 2 specialistë janë në ngarkim.KU “Logos”

<p>bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>garanton akses në katalogun elektronik të bibliotekës www.orthodoxalbania.org</p> <p>Studentët kanë akses në bibliotekën online JSTOR dhe ESCO. Institucioni është drejt konkludimit të marrëveshjes për përdorimin e bibliotekës së pasur dixhitale online të Universitetit Aristoteli të Selanikut (Greqi) [Ev: aneks 33.3; aneks 33.4].</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC të cilët kanë akses dhe në internet duke mundësuar aksesimin në bibliotekat virtuale tek të cilat institucioni ka abonime. Përmes vendimit nr.25 datë 29.10.2021, nga Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës është bërë edhe miratimi i programit të trajnimit për përdoruesit e bibliotekës ku përfituesit kryesore të tij janë studentët dhe stafi akademik. Ky trajnim do të jetë i detyrueshëm dhe do të zhvillohet në fillim të çdo viti akademik. Synimi kryesor i trajnimit është mënyra e kërkimit të bibliografisë, menaxhimit e burimeve digjitale dhe të printuara për studimet në shkencat kompjuterike, përdorimin e platformës elektronike etj. [Ev:aneks 40.2]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Një nga rekomandimet e dhëna në vendimin e Bordit të Akreditimit nr.49 datë 05.07.2019 ne lidhje me programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë e Zbatuar” të KU “Logos” është: “...Institucioni të vijojë në pasurimin dhe përditësimin e bibliotekës me tituj në fushën e TIK”</p> <p>Pasurimi i bibliotekës ka qenë në fokus të plan veprimit në drejtim të përmbushjes së rekomandimit të dhënë nga Bordi i Akreditimit. Gjatë tre viteve të fundit ky program studimi është pasuruar me 63 libra (39 në gjuhën shqipe, 15 në greqisht, 9 në anglisht) dhe 50 tituj (26 në shqip, 15 në greqisht dhe 9 në anglisht). Kërkesat për pasurimin e saj burojnë nga Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës dhe prokurohet pas miratimit të dhënë nga ADIZSnistratori. GVJ në vizitën e kryer konstaton pasurimin e stendave të librave në fushën e informatikës ndonëse akoma mbetet problematike fondi në gjuhën shqipe. Në vizitë u konstatua puna që duhet bërë në drejtim të mënyrës së katalogimit të librave në stenda për të krijuar me lehtësira të studentëve [Ev: aneks 33.2; aneks 33.3; aneks 33.4, aneks 33.5, aneks 33.6, vizitë në institucion].</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në</p>	<p>Biblioteka është e hapur për stafin akademik dhe studentët gjatë orarit të punës së KU “Logos” (08.00-16.30) [Ev: aneks 33.1 neni 4, pika 2].</p>

përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në vizitën e zhvilluar në këtë strukturë nga ana e punonjësve u theksua angazhimi i tyre edhe gjatë pandemisë. Gjatë kësaj periudhe studentët kanë përdorur katalogun elektronik të bibliotekës duke bashkëpunuar me punonjëset për sigurimin e materialit nëpërmjet skanimit ose duke ju dhënë adresat elektronike në varësi të kërkesave të tyre [Ev: aneks 33.3; vizitë në bibliotekë]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e aDIZSnistrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit aDIZSnistraton të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Institucioni garanton menaxhimin e sistemit të informacionit në lidhje me personelin akademik dhe studentët. KU Logos” ruan të dhënat personale të studentëve. Proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave të studentëve kryhen mbi bazën e parimit të ruajtjes së konfidencialitetit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale [Ev: aneks 1- neni 42].</p> <p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në programin e studimit Bachelor në ‘Informatikë e Zbatuar’ garantohet nga Rregulloret përkatëse [Ev: aneks 6; aneks 36.2]. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore e cila kryen funksionin e saj bazuar në Rregulloren për Sekretarinë Mësimore të miratuar në Qershor 2017 [Ev: aneks 8]. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të rregjistrimit themeltar, rregjistrimit të arritjeve akademike, rregjistrimit të kursit dhe rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e rregjistrimit/transferimit [Ev. Aneks 46.2; aneks 46.2.1; aneks 46.2.; anks 46.2.3; anes 46.2.4; aneks 46.2.5; aneks 46.2.6; Vizita në institucion]</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit	KU “Logos” administron sistemin e brendshëm të informacionit, strukturat administrative si zyra e Burimeve

<p>aDIZSnistron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit aDIZSnistrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Njerëzore dhe Arkivë – Protokollit, Sekretaria Mësimore, Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës menaxhojnë informacionin bazë në lidhje me stafin akademik dhe studentët dhe programin e studimit në tërësi. Neni 41 në Statut të KU “Logos” përcakton qartë dokumentacionin e procesit mësimor i cili administrohet nga Sekretaria Mësimore dhe strukturat administrative [Ev:aneks 1 – neni 41] Ruajtja dhe administrimi i informacionit bazohet në politikat e privatësisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit [Ev:aneks 36.1, aneks 36.2; aneks 36.3; aneks 36.4]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni përdor sistemin Teams i cili ofron akses dhe informacion për personelin akademik dhe studentët. Aplikacioni Outlook ofron përdorim në një adresë e – mail zyrtar nga Logos duke garantuar autenticitetin për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm [Ev: RVB].</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Për komunikim interaktiv përdoret platforma Microsoft 365 dhe aplikacioni i saj Microsoft Teams i cili përdoret për një komunikim staf akademik dhe studentët dhe për realizimin e trajnimeve. Për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e saj është në dispozicion zyra e IT-së ku të punësuar janë studentë të diplomuar në këtë program studimi [Ev:vizitë në institucion]. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit për stafin akademik dhe studentët. [Ev:aneks 34.1; aneks 34.2; aneks 34.3 dhe aneks 34.4]</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e aDIZSnistrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitën në institucion, sistemi Teams garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq sistemi jep informacion për pjesëmarrjen e studentëve, shpërndarjen e materialeve, progresin dhe vlerësimin e tyre në lëndët mësimore [Ev: RVB; aneks 27.4].</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të</p>	<p>Faqja web e KU Logos (është e mirëorganizuar dhe ofron një informacion të zgjeruar mbi institucionin në përgjithësi si dhe programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë e Zbatuar”. Gjithashtu, nëpërmjet faqes web, mund të përftohet informacion i zgjeruar për stafin akademik, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfundimin e bursave të studimit dhe çdo lloj informacioni tjetër,</p>

paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	që ka të bëjë me aktivitetet e përditshme të Intitucionit në gjuhën shqipe dhe anglisht [Ev:aneks 35; www.kulogos.edu.al]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6


Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	KU Logos ushtron veprimtari jofitimprurëse. Shpenzimet që kryhen mbulohen nga fondet e vendosura në dispozicion nga Kisha Othodokse si edhe mbulohet nga të ardhurat e vet institucionit [Ev:aneks 30.14]. KU Logos zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 2018-2024. Siç është theksuar edhe në këtë dokument të përmendur më sipër nga ana e institucionit pranohet se organizimi i brendshëm financiar paraqet vështirësi. Citojmë këtu paragrafin 2 faqe 5 [Ev:aneks 3].” Për shkak të evolucionit historik të “Logos” ndër vite, faza e tanishme e zhvillimit dhe stili i veprimit tregojnë një numër mangësish. Nga pikëpamja e financimit ende gjendet nën ombrellën e Fondacionit “LOGOS”. Tani ai duhet të hapë librat e vet të llogarisë si një aneks i Fondacionit dhe të mbajë transaksione të veta. Kjo paraqet një seri problemesh kontabel dhe ligjore, të cilat duhet të zgjidhen në mënyrë që të vendoset pavarësia e saj financiare”. Gjithsesi GVJ konstaton një sërë dokumentesh të cilat tregojnë se institucioni harton raporte financiare në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në akordancë me politikën e brendshme financiare.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive	Hartimi i plan buxhetit është i hartuar në nivel institucional [Ev:aneks 51, tabela 18]. Të ardhurat gjenerohen nga: <ul style="list-style-type: none"> • tarifa për shkollim e cila bazuar edhe në evidencat e paraqitura nga institucioni kanë një rritje për periudhën 2020-2021 krahasuar me 2018-2019 dhe; • donacionet, aktivitete siguroese, fonandacione etj të cilat një rritje për periudhën 2020-2021 krahasuar me 2018-2019;

<p>mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plan financimi përfshin financimin e burimeve njerëzore, mirëmbajtjes, bursat për studentët, financimin për kërkimin shkencor, pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca ose për studim doktorature etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni ka emëruar një ekspert kontabel të jashtëm të autorizuar përmes vendimit të Bordit Drejtues të Fondacionit për të realizuar procesin e auditimit të jashtëm financiar në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit të pasqyrave financiare [Ev: aneks 30.14].</p> <p>GVJ konstaton se raport auditit i jashtëm për vitin financiar 2020 është në nivel institucional.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ u informua se prej Zyrës së Financës kryhet në mënyrë të vazhdueshme një analizë financiare për ecurinë e programeve të studimit dhe prej saj nxirren dhe përpunohen të dhëna mbi ecurinë e programeve të studimit, ndërhyrjet e posaçme, apo dhe mbështetjet e domosdoshme kur kërkohet, në mënyrë që të sigurohet ecuria dhe mbarëvajtja normale e programeve të studimit. <i>Megjithatë GVJ nuk gjeti informacion të detajuar mbi ecurinë e programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Zbatuar" për të mundësuar një gjykim më të thelluar të ecurisë dhe perspektivës së këtij programi studimi [Ev. RVB; aneks 30.14]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni ka qëndrueshmëri financiare. Synimi që institucioni paraqet në Strategjinë e Zhvillimit paraqesin edhe nevoja financiare për zgjerim. Kjo sjell që riorganizimi dhe zgjerimi i "Logos" në universitet do të shoqërohet edhe me shumë kosto operationale. Nga ana tjetër</p>

studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	pagesat për shkollim dhe tarifa të tjera të ngarkuara aktualisht për studentët janë më të ulëta në krahasim me institucionet e tjera arsimore private. Në këtë drejtim bazuar edhe në strategjinë afatgjatë të Departamentit të Informatikës së Zbatuar & Statistikë ku synohet që të hapet Master Profesional në “Informatikë e Zbatuar” dhe numri i ulët i studentëve në ciklin e parë Bachelor “Informatikë e Zbatuar” sjellin edhe nevojën për rishikimin e politikave financiare [Ev: aneks 3, aneks 5]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X





V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatike e Zbatuar” është ndërtuar referuar kornizës së nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, e organizuar në 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale në tre vite akademike. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ka të institucionalizuar të gjithë procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve në kete program studimi. GVJ i gjen të shprehur qartë në dokumenta baze në nivel institucional deri në nivel programi si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Statuti i KU “Logos” [Ev:aneks 1:neni 30, neni 34, neni 36, neni 40, neni 41]; 2. Rregullore e Përgjithshme e KU Logos [Ev:aneks 4: kreu IX; X; XI; XII; XIII; XIV; XV dhe XVI]; 3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara [Ev:aneks 5: Kreu IV; V; VI; VII dhe VIII]; 4. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë e Zbatuar” [Ev:neks 6: neni 9-22]; <p>Këto dokumenta përshkruajnë qarte procedurat dhe strukturat përgjegjëse në lidhje me procesin e regjistrimit të studentëve, të zhvillimit të procesit mësimor, të transferimit, procedurën e ankimimit dhe diplomimit të tyre. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019 .</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e ndjekura nga KU “Logos” janë të mirëpërcaktuara duke garantuar barazinë tek çdo student në këtë program studimi. GVJ konstatoi se garancia sigurohet nëpërmjet përcaktimit në rregulloret e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Informatikës së</p>




	Zbatuar & Statistikës dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse [Ev. Aneks 1, aneks 2, aneks 3, aneks 4, aneks 5, aneks 6,; Takime në institucion]
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar qartë procedurat në lidhje me pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve. Kriteret e pranimit bazohen në Ligjin nr.80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Në dokumentat bazë institucionale janë shprehur qartë kushtet dhe kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi. Neni 30 në Statut të KU “Logos”, neni 78 në Rregulloren e Përgjithshme të KU “Logos” përcakton kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve. Vlen të përmenden në këtë drejtim si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kandidati ka përfunduar me sukses ciklin e parë të arsimit të mesëm dhe plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Keshillit të Ministrave; Plotëson kriteret shtesë të pranimit në rast kur institucioni ka miratuar për programe të veçanta studimit; <p>[Ev: aneks 1, aneks 4]</p> <p>GVJ konstatoi se një ndihmesë të rëndësishme në procesin e informimit të kandidatëve për studentë dhe njohjes së kriterëve dhe procedurave japin:</p> <ol style="list-style-type: none"> faqja web e institucionit http://www.kulogos.edu.al/al/. Platfoma U-Albania ku KU “Logos” ku mund të merret informacion në lidhje me programin e studimit (kriteret e pranimit dhe kuotat); Broshura, fletëpalosje dhe takime informuese; <p>Administrimi i procesit mësimor (pranimet, detyrat dhe përgjegjësitë e studentit, të drejtat, udhëzime për provimet, detyrat/projektet e kursit, frekuentimi, vlerësimi, procedurat e ankimimit dhe transferimit, shërbimet mbështetëse, biblioteka, këshillat studentore, diplomimi dhe diplomat me suplementin përkatës etj) kryhet bazuar në nenin 41 në Statut të KU “Logos”, në Rregulloren e Përgjithshme dhe në dokumentat shoqëruese dhe mbështetëse të programit të studimit [Ev: aneks 1, aneks 2, aneks 3, aneks 4, aneks 5 dhe aneks 6].</p>

	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë e Zbatuar”			
	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
	2019-2020	11	4	15
	2020-2021	14	1	15
2021-2022	15	2	17	

[Ev:aneks 19]

Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore ndjekin procesin e studentëve që në hyrje deri në diplomimin e tyre.

Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.

Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të krediteve jepen në Rregulloren e Përgjithshme të KU “Logos”. Këto informacione mund të aksesohen edhe nëpërmjet faqes web të institucionit (<http://www.kulogos.edu.al/a/aDIZSsions.html>).

GVJ konstaton mungesë të vendosjes së kriterëve të pranimit në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Informatike e Zbatuar”. GVJ sugjeron përfshirjen e “kriterëve të pranimit” si një nen ligjor i veçantë në këto rregullore.

Kriteret e veçanta përcaktohen nga Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës. Për vitin 2002-2023 si kriter i vetëm dhe bazë i pranimit të studentëve është nota mesatare e përfutur në arsimin e mesëm e përcaktuar nga VKM në fuqi [Ev: aneks 40.13].

Si kriter specifik përcaktohet nota mesatare jo më e vogël se 7.5. GVJ konstatoi se kriteri i notës mesatare në përgjithësi është zbatuar. GVJ konstaton se një rritje e mesatares së studentëve të regjistruar për herë të parë [Ev: aneks 19].

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë e Zbatuar”		
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nota mesatare e studentëve në hyrje
2019-2020	15	7.77

	2020-2021	15	7.75
	2021-2022	17	8.4
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar qartë procedurat në lidhje me pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve. Kriteret e pranimit bazohen në Ligjin nr.80/2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Institucioni zbaton të gjithë udhëzimet dhe ndryshimet e përcaktuara nga MAS në lidhje me vendosjen e kuotave të pranimit dhe procedurave në lidhje me regjistrimin e studentëve.</p> <p>Për kriteret e pranimit në ciklin e parë, Institucioni bazohet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Udhëzimin e MAS nr.16 datë 29.06.2022;</i> <i>Udhëzim i MASR nr.11 datë 02.06.2021;</i> <i>Udhëzim I MASR NR.10 datë 15.05.2019;</i> <i>Urdhër i përbashkët nr.8 datë 3006.2022;</i> <i>VKM nr.386 datë 0106.2022</i> <i>Udhëzim mbi fazën e katërt të regjistrimeve për vitin akademik 2022-2023;</i> <p>Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta shpallen nga KU Logos dhe i bëhen me dije zyrtarisht MAS dhe QSHA-së. Në përfundim të afatit të lejuar për regjistrime në çdo vit akademik KU Logos i dërgon QSHA-së listën përfundimtare të studentëve të regjistruar për t’u administruar në regjistrin kombëtar të studentëve dhe për t’u pajisur me një numër matrikulimi (regjistrimi) [Ev: aneks 1 neni 31].</p> <p>GVJ zhvilloi një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstaton se të gjithë studentët janë të pajisur me një numër matrikulimi duke gjetur një zbatim korrekt në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi [vizitë në institucion].</p> <p>Në Statut dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit janë përcaktuar qartë edhe regjistrimi i studentëve nga vende të tjera dhe regjistrimi i tyre në akordance me kriteret dhe përcaktimet ligjore [Ev: aneks 1, aneks 4]</p>		
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>Kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik [Ev. https://www.kulogos.edu.al/al/aDIZSsions/]. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ u informua se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë fletpalosjet, broshurat, takime informuese (“Open Days”), panairi “Work & Study”, takimet me maturanet e shkollave të mesme të organizuara nga institucioni në bashkëpunim edhe me Zyrën e</p>		


përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës nga MAS [Ev. RVB; Takime në institucion; aneks 47.1, aneks 46.8, aneks 47.4, aneks 46.1.9].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>GVJ konstaton se një informacion i gjerë vihet në dispozicion të studentëve në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementet detyrues të tij dhe progresi i tyre në vite deri në përfundim të studimeve. GVJ evidenton që burimet bazë të informimit janë si vijojnë më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Përgjithshme e KU Logos e cila në kreun IX, X, XII, XII, XIII, XIV dhe XV përshkruan të detajuar informacionin në lidhje me pranimin, regjistrimin, transferimin, ndjekjen e studimeve, praktikat profesionale, diplomimin dhe dispozita shtesë në lidhje me procesin mësimor [Ev: aneks 4]; • Rregullorja e programit të studimit ‘Informatikë e Zbatuar’ që përshkruan qartë organizimin e studimeve [Ev: aneks 6, neni 9 - 21]; • Plani mësimor i reflektuar edhe në rregulloren e programit të studimit [Ev: aneks 6, aneks 11.3]; • Syllabuset për çdo lëndë të cilat vihen në dispozicion të studentëve në fillim të çdo semestri nga stafi akademik, të cilat pasqyrojnë përmbajtjen e lëndës, objektivat, vlerësimin dhe literaturën detyruese [Ev: aneks 11.2]; • Guida e studentit e hartuar nga KU Logos në kuadër të informimit të studenteve [Ev: aneks 47.1]; • Revista Studentore e cila botohet një herë në tre muaj dhe jep informacion studentëve në lidhje me aktivitetet bazë të institucionit [Ev: aneks 47.1]; • Broshura dhe fletëpalosje për programin e studimit të cilat u vihen në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve në

	<p>“Open Days” dhe në çdo aktivitet informues që ndërmerret në këtë kuadër [Ev: aneks 47.1];</p> <ul style="list-style-type: none"> • Orari mësimor i cili pasqyrohet edhe në website [Ev: aneks 47.2]; • Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës shpërndan informacion në lidhje me ndryshimet në modulet dhe detyrimet përkatëse të studentëve. Njësia bazë është përgjegjëse edhe për oraret mësimore, mënyrën e organizimit të programit mësimor dhe ndjekjen e progresit të studentëve përmes analizimit të rezultave të tyre në fund të çdo semestri [takim në institucion]. 																									
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Procedurat e transferimit shprehen qartë në dokumentat bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Neni 34 në Statut të KU Logos [Ev: aneks 1]; Neni 85-88 në Rregulloren e Përgjithshme të KU Logos [Ev: aneks 4]; Institucioni ka hartuar edhe miratuar “Rregulloren e Transferimeve” mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe zbatohet nga të gjithë strukturat [Ev: aneks 46.1.4]. <table border="1" data-bbox="595 1178 1335 1626"> <thead> <tr> <th colspan="5">Studente të transferuar sipas viteve në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatike e Zbatuar”</th> </tr> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Viti I</th> <th>Viti II</th> <th>Viti III</th> <th>Studentë të transferuar për brezat</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ shqyrtoi me vemendje praktikën e transferimeve dhe ekuivalentimeve të kryer nga Sekretaria Mësimore dhe konstaton se janë zbatuar me korrektësi klauzolat ligjore [Ev: aneks 1; aneks 46.1.4; vizitë në institucion; aneks 19];</p>	Studente të transferuar sipas viteve në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatike e Zbatuar”					Viti akademik	Viti I	Viti II	Viti III	Studentë të transferuar për brezat	2019-2020	2	1	1	4	2020-2021	-	-	1	1	2021-2022	-	1	1	2
Studente të transferuar sipas viteve në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatike e Zbatuar”																										
Viti akademik	Viti I	Viti II	Viti III	Studentë të transferuar për brezat																						
2019-2020	2	1	1	4																						
2020-2021	-	-	1	1																						
2021-2022	-	1	1	2																						
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e</p>	<p>Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë.</p>																									



<p>procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve shprehet në dokumentat bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kreu XI – Ndjekja e studimeve në Rregulloren e Përgjithshme të KU Logos [Ev: aneks 4]; Kreu VI në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara [Ev: aneks 5]; Kreu “Vlerësimi i Studentit” në Rregulloren e Programit të Studimit “Informatikë e Zbatuar”; <p>Studentët informohen në fillim të çdo lënde prej stafit akademik dhe prej secilit pedagog në lëndën përkatëse, mbi elementet e programit të lëndës, duke përfshirë dhe vlerësimim. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me procesin e diplomimit që në fillim të vitit të tretë akademik. E drejta për diplomim dhe menyra e organizimit të saj janë shprehur qarte në:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kreu XIV në Rregulloren e Përgjithshme të KU Logos; Kreu VII – Diplomimi në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara [Ev: aneks 5] Neni 15 në Rregulloren e Programit të Studimit “Informatikë e Zbatuar” <p>Informacioni në lidhje me procedurën e diplomimit është pasqyruar edhe në website http://www.kulogos.edu.al/al/general-regulation.html;</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>KU Logos dhe Departamenti i Shkencave të Aplikuara janë aktive në drejtim të informimit të kandidateve dhe studentëve. Faqja website ofron një gamë të gjerë informimi në lidhje me programin mësimor, kuotat, kriteret e veçanta, bibliotekën, bursat etj, broshura, fletëpalosje vihen në dispozicion të publikut me qëllim informimi. Fushata ndërgjegjësimi “Ditët e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës” ndërmerren duke organizuar edhe takime me gjimnazistët e shkollave të mesme dhe informimin e tyre për programin e studimit [Ev: aneks 46.1.8; aneks 46.1.10; aneks 43.2]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



				X
--	--	--	--	---

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre [Ev. Takime në institucion]. Informacioni në lidhje me këta elementë shpërndahet edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, notat etj [Ev. Takim në Sekretarinë Mësimore].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion bazë në lidhje me programin mësimor. Kurrikula e programit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë e Zbatuar” pasqyrohet qartë në rregulloren e programit të studimit [Ev: aneks 6]. Objektivat dhe veprimtaritë formuese, mundësia për punësim dhe kualifikime të mëtejshme pasqyrohen edhe në website. Çdo kandidat dhe student mund të aksesojë lehtësisht kurrikulën e programit të studimit dhe të informohet në lidhje me përmbajtjen e saj [http://www.kulogos.edu.al/al/bachelor_infoeko.html].</p> <p>Syllabuset vihen në dispozicion të studentëve në fillim të vitit akademik [takim me stafin akademik]. Orari mësimor online pasqyrohet edhe në website (http://www.kulogos.edu.al/al/schedules.html)</p> <p>Sekretaria mësimore informon studentët në lidhje me modulet, detyrimet e studentëve në lidhje me to dhe ofron asistencë për çdo paqartësi që mund të kenë [vizitë në institucion].</p> <p>Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me procesin mësimor përmes adresës së e-mailit për oraret e</p>

	mësimi, oraret e provimeve, konsultimet, praktikën profesionale etj.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me objektivat formues të programit të studimit dhe mundësitë për punësim të tyre. Zyra e Çështjeve Studentore dhe Karrierës zhvillon veprimtari aktive në drejtim të informimit të studentëve në lidhje me punësimin. Mundësitë për punësim janë dhënë qartë edhe në website http://www.kulogos.edu.al/al/bachelor_infoeko.html</p> <p>ku çdo student në përfundim të studimeve të tij mund të punësohet si programues, analist, konsulent i sistemeve TI, te aplikimeve web, në sektore të ndryshme të kompanive prodhuese, organizata tregtare, në sektoret e TI-së etj.</p>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>GVJ konstaton se Departamenti Informatikës së Zbatuar & Statistikës mundëson një shpërndarje të informacionit në shumë drejtime gjatë gjithë karrierës universitare në mënyrë të vazhdueshme. Përmes punës së tij studentët informohen në lidhje me të drejtat, detyrat dhe udhëzimet informuese për procesin mësimor. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, formularë të ndryshëm, modele të testeve/provimeve që përdoren në institucion, aplikime për bursë, mund të aksesohen nëpërmjet faqes web të institucionit (https://kulogos.edu.al). Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore [Ev. RVB; Takime në institucion]</p>			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	<p>GVJ u informua se studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit mësimor etj nëpërmjet platformes Teams. Në vijim të punës informuese gjatë situatës së covid-19 ka shërbyer edhe rubrika “Logos Online” [vizitë në institucion].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, aDIZSnistron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Sekretaria Mësimore zotërojnë të dhëna në lidhje me studentët e diplomuar në cdo vit akademik. Mbështetur në ligjin nr.80/2015 të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në sekretarinë mësimore. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave [Ev:Plotësim dok.]. Referuar [Ev:51 tab 21], numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është:

Viti Akademik	Numri i studentëve të regjistruar
2018-2019	15
2019-2020	15
2020-2021	17

Në Rregulloren e Përgjithshme dhe në Rregulloren e Programit të Studimit është theksuar qe procesi i diplomimit zhvillohet me provim formimi dhe temë diplome. Të drejtën për të zhvilluar temë diplome e kanë studentët qe zotërojnë mesataren mbi 8.5. Për vitin akademik 2021-2022 vetëm dy studentë mbrojtën temë diplome [takim me stafin akademik; vizitë në Sekretarinë Mësimore]

GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrin të lëshimit të diplomave, suplementin e diplomës dhe çertifikatave është në përputhje me standartet dhe udhëzimet e MAS dhe në përputhje me nenin 4 në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore. [vizitë në institucion, dokumenti shtese; aneks .46.1;Tabela 23; aneks 11.4; aneks 11.5]

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe

Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit për çdo student që në momentin e regjistrimit të tij deri në perfundim të studimeve. Kjo strukturë administron të dhëna në lidhje me procedurat e transferimit dhe ç' regjistrimet që mund të ketë gjatë vitit akademik. Të dhënat pasqyrohen edhe në Departamentin e Shkencave të Aplikuara. Bazuar në Rregulloren e miratuar në Qershor 2017 Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për:

- a. Regjistrin themeltar të studentëve;

<p>largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>b. Regjistrin e arritjeve akademike; c. Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave; d. Regjistrin e grupit;</p> <p>Bazuar në nenin 11 të Rregullores së Sekretarisë Mësimore, kjo e fundit mban të dhënat (regjistrat bazë) edhe në formë elektronike. Në rast mospërputhje prevalon regjistri në formë të shkruar me dorë [Ev:dok shtesë: rregullore e sekretarisë mësimore; ankes 46.2.6; aneks 46.2.5; aneks 46.2.3; aneks 46.2.4; aneks 46.2].</p> <p>GVJ konstaton gjatë vizitës së kryer në Sekretarinë Mësimore zbatimin me korrektësi të ruajtjes së të dhënave. GVJ në përputhje gjeti regjistrimin përfundimtar të studentëve me numrin përkatës të matrikulimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e studentëve. GVJ verifikoi në vizitën e kryer në Sekretarinë Mësimore regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe në tërësi plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Në verifikimin e regjistrit të arritjeve akademike u evidentua edhe notë përmiresuese një e drejtë kjo e studentit për të përmiresuar deri në 3 lëndë.</p> <p>Sekretaria Mësimore administron edhe procesverbalet e provimeve. Kjo e drejtë buron nga neni 4 në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore [Ev:dok shtesë: rregullore e sekretarisë mësimore].</p> <p>GVJ u njoh me procesverbale të cilat ishin pjesë e verifikimit të hedhjes së notave në regjistrin e arritjeve akademike. Gjatë këtij procesi GVJ konstaton një mungesë të reflektimit të pikëve të grumbulluar nga studenti gjatë vitit dhe në provimin përfundimtar. Në procesverbal reflektohet vetëm nota përfundimtare.</p> <p><i>Për sa më sipër GVJ sugjeron, një rishikim të formatit të procesverbalit ku të pasqyrohen qartë edhe vlerësimi me pikë të studentit gjatë vitit dhe rezultatin e tij në provimin përfundimtar. Ky rishikim do të sjellë një rritje të transparencës dhe një lehtësim të punës së sekretarisë në lidhje me informimin ndaj studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të</p>	<p>Të dhënat e studentëve ruhen në regjistrat bazë dhe janë subjekt kontrolli dhe verifikimi të vazhdueshëm [Ev: aneks 46.2.5]. Dokumentacioni baze ruhet në formë elektronike (excel) dhe në të shkruar. Regjistrat ruhen në mënyrë të përhershme në KU Logos. Dokumentacioni pas plotësimit të tij ruhet edhe në Arkiven e Shtetit, ndërsa kopja e njehsuar me origjinalin ruhet në arkivën e institucionit. Të dhënat mbrohen, ruhen dhe administrohen në</p>

sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

pëputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në bazë të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" [Ev:dok shtesë_ rregullore e sekretarisë mësimore, vizitë në institucion; aneks 46.2.1- 46.2.6].

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.


Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës harton në fund të vitit një raport vjetor dhe të dhënat reflektohen edhe raportin vjetor institucional [Ev: aneks 24.1; aneks 24.2; anEks 24.3; aneks 24.4]. Në raportin vjetor njesia bazë zhvillon një analizë të detajuar në lidhje me:

- a. Realizimin vjetor të objektivave të programit të studimit;
- b. Numrin e studentëve të regjistruar;
- c. Numrin e studentëve të diplomuar;
- d. Numrin e studentëve të transferuar;
- e. Tarifat e shkollimit për studentët;
- f. Kalueshmëria e studentëve për vitin akademik e shprehur në shifra dhe në përqindje;
- g. Të dhënat e punësimit të studentëve në përputhje me diplomën;
- h. Anketimet e zhvilluara në bashkëpunim me NJSBC dhe pjesëmarrja e studentëve në këto anketime;
- i. Marrëveshjet e reja të lidhura me kompanitë e biznesit;

GVJ u njoh me analizën vjetore (2020-2021) që Departamenti i Informatikës së Zbatuar ka hartuar në fund të vitit akademik. Në këtë raport një pjesë e analizës është edhe ecuria e procesit mësimor, numri i studentëve të regjistruar, kalueshmëria në çdo lëndë dhe numri i studentëve të diplomuar dhe disa prej të dhënave pasqyrohen në tabelat si vijon më poshtë:

"Informatikë e Zbatuar" (2020-2021)	Vit i parë	14 studentë
	Vit i dytë	13 studentë
	Vit i tretë	14 studentë
	Total	41 studentë

"Informatikë e Zbatuar" (2020-2021)	Numri i studentëve	IAL nga transferohen
	1	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës



Programi i studimit	Studentë të regjistruar për herë të parë	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit	Nota mesatare
“Informatikë e Zbatuar” (2020-2021)	14	6.83	14	7.75

“Informatikë e Zbatuar” (2020-2021)	Viti	Nota mesatare	Kalueshmëria
	Vit I	6.83	93%
	Vit II	8.20	98%
	Viti III	7.75	99.5%

Programi i studimit	Viti akademik	Numri total i studentëve të diplomuar	Numri total i std. të punësuar në përputhje me diplomën	Numri total i std. të punësuar jo në përputhje me diplomën
“Informatikë e Zbatuar”	(2020-2021)	14	9	5

GVJ sugjeron qe analiza vjetore e njësisë bazë duhet të shoqërohet edhe me pasqyrimin e problematikës dhe hapat konkrete për përmirësimin e tyre të cilën GVJ e konstaton mungesë të raportit. [Aneks 24; aneks 24.1; aneks 24.2; aneks 24.3; aneks 24.4]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e

përmirësimin të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në proceset vendimarrëse është një atribut i shprehur në dokumentat bazë dhe një kërkesë e MAS. Neni 40 në Statut të KU Logos përcakton qartë të drejtën e studentëve për tu organizuar në Këshilla studentore në nivel të njëjësive kryesore. GVJ konstaton përfaqësimin e studentëve në organet kolegjiale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Senatin Akademik (përfaqësues është 1 student nga Departamenti i Informatikës së Zbatuar);</i> • <i>Komisioni i Perhershëm i Garantimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;</i> • <i>Komisioni i Perhershëm i Marrëdhënieve me studentët;</i> • <i>Këshilli i Etikës; [Ev:aneks 1]</i>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët janë të organizuar në Këshillin Studentor i cili vepron bazuar në Statutin e tij dhe financohet nga Institucioni [Ev:aneks 1; aneks 46.3; aneks 46.1.11].</p> <p>Studentët janë pjesë e procesit të vlerësimit të programit mësimor dhe të stafit akademik. Ata marrin pjesë aktive në sondazhet që kryhen në fund të çdo semetri akademik dhe japin mendimin dhe vlerësimin e tyre në lidhje me programin mësimor dhe stafin akademik [vizitë në institucion].</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në hartimin e programeve të studimit merren në konsideratë gjithë rekomandimet për ngarkesën akademike të studentëve në auditor dhe mësim jashtë auditorit sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi. Numri i orëve totale në auditor është 1710 [Ev: aneks 11.3].</p> <p>Programi nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën 20%. Në takimin e zhvilluar me stafin akademik u theksua përmirësimet që bëhen në drejtim të moduleve për të përmirësuar përmbajtjen e tyre dhe në lehtësimin e ngarkesës për disa tema të cilat shfaqin vështirësi për studentët në asilimin e tyre. Në këtë drejtim u sugjerua përfshirja e lëndëve me zgjedhje në program [takim me studentët].</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni përmes anketimeve të kryera përfshin studentët në dhënien e mendimit të tyre në lidhje me procesin mësimor. Takimi i zhvilluar me studentet theksoi pjesëmarrjen e tyre në sondazhe dhe dhënien lirshëm të mendimit të tyre në lidhje me lëndët që janë zhvilluar gjatë semestrit dhe vlerësimin për stafin akademik [takime me studentët].</p> <p>Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në anketime. Kjo është edhe një nga çështjet që trajtohet edhe në raportet vjetore [Ev: aneks 24.1; aneks 24.2; aneks 24.3; aneks 24.4]</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Dokumentat baze institucionale japin qartë të drejtat që ka studenti në lidhje me barazinë në procesin mësimor, procesin e vlerësimit dhe të ankimimit [Ev:aneks 1; aneks 4]. Në takimin e zhvilluar me stafin akademik u theksua roli i Kujdestarit Akademik i cili ndër funksionet e tij ka edhe administrimin e ankesave të studentëve në lidhje me rezultatet e provimit [Ev: takim me stafin akademik; aneks 46.1.13]. Gjatë mbledhjes së zhvilluar me studentët në institucion, GVJ konstaton njohjen nga e tyre të procedurës së ankimimit ndonëse nuk u sollën shembuj në këtë drejtim [Ev: takim me studentët]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të</p>	<p>Institucioni garanton informimin e studentëve përmes zbatimit të akteve ligjore të shprehur në dokumentat bazë [Ev:aneks 1- 6]. Në shërbim të informimit të studentëve janë</p>

<p>informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>edhe strukturat mbështetëse administrative: Sekretaria Mësimore, Zyra e Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës, Biblioteka etj. Departamenti i Informatikës së Zbatuar angazhon në çdo vit mësimor Kujdestarin Akademik i cili është përgjegjës për informimin, dhënien e ndihmës dhe mbështetjes ndaj studentëve. Për informimin e studentëve shfrytëzohen rrjetet sociale, njoftimet në ëbsite, platformat elektronike duke garantuar shpërndarjen e tij në kohë reale [takime në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni zhvillon tutoriatin për ti ardhur në ndihmë studentëve. Në këtë drejtim me vendim të Senatit Akademik është miratuar edhe Rregullorja “Mbi funksionimin e udhëheqjes/kujdestarisë (tutoratit) për studentët e Kolegjit Universitar “Logos”. Kujdestari akademik është aktiv dhe zhvillon takime javore me studentët dhe informon, këshillon dhe asiston në çështjet që ata kanë në lidhje me procesin mësimor [Ev:takim me stafin akademik; aneks 46.1.13].</p> <p>Në KU Logos tashmë është ngritur në nivel institucional edhe zyra e Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë kryen funksionin e saj bazuar edhe në rregulloren e miratuar në vitin 2020 “Mbi funksionet e zyrës së çështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës në KU Logos” [Ev: aneks 10]. Kjo zyrë është përgjegjëse për informimin e studentëve, këshillimin dhe ofrimin e asistencës. Zyra e Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës bashkëpunon me Sekretarinë Mësimore duke marrë të dhënat baze të kontaktit për çdo student. Kjo zyrë bashkërendon punën për të ndjekur ecurinë e studentëve dhe punësimin e tyre [takim në institucion].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe</p>	<p>KU Logos ka ngritur zyrën e Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë funksionon në bazë të Rregullores “Mbi Funksionimin e Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës në Kolegjin Universitar “Logos”” të miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.20 datë 23.03.2020 [Ev:aneks 10]. Zyra drejtohet nga Koordinatori dhe një numër studentësh vullnetare të cilët japin asistencë në aktivitetet që kjo zyrë ndjek [Ev: aneks 10, neni 4]. Neni 4 në Rregulloren e zyrës së Çështjeve Studentore & Këshillimit të Karrierës përcakton qartë punën e kësaj zyre në drejtim të këshillimit dhe dhënies së udhëzimeve në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale. Kjo zyrë në bashkëpunim me departamentin e Informatikës së Zbatuar &</p>

orientimin në tregun e punës.	Statistikës organizon praktikat profesionale të studenteve dhe monitoron ecurinë e tyre.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Misioni i zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës është rritja e punësueshmërisë së studenteve. Kjo zyrë shërben për një përfaqje më të mirë të studentëve me tregun e punës duke i mbështetur dhe inkurajuar në zhvillimin e plotë të potencialit të tyre, për një performancë më të mirë në shoqëri [Ev:aneks 10]. Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës mbledh të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve duke ndjekur studentët e diplomuar. Kjo zyrë është përgjegjëse për organizimin e panairit të punës duke sjelle një mundësi studentëve të njihen me kërkesat e punëdhënësve [Ev:aneks 47.3, aneks 10].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga takimet me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, GVJ konstaton se KU Logos ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në këtë drejtim GVJ konstaton disa dokumenta të rëndësishëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> Statut i KU Logos: Kreu VIII- Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë [Ev:aneks 1]; Politika për Sigurimin e Cilësisë [Ev:aneks 7.2]; Rregullore për Sigurimin e Cilësisë – [Ev:aneks 7.1]

	<ul style="list-style-type: none"> Instrumentat e Miratuara të Matjes së Cilësisë [Ev: aneks 7.5]
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>KU Logos është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Për kryerjen e kësaj detyre KU Logos ka ngritur në vitin 2011 edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përmes vendimit nr. 11 datë 7.11.2011 dhe në vijim të Statutit të KU Logos përmes vendimit të Senatit Akademik nr.43 datë 08.02.2018 dhe reflektuar edhe në kreun VIII, neni 43 në Statutit. [Ev: aneks 7.3; aneksi 1]</p> <p>Strukturat përgjegjëse të ngritura në kuadër të punës për sigurimin e cilësisë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (nivel universiteti) Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë (nivel universiteti) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (nivel universiteti)
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>KU Logos i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit institucional si edhe çdo program studimi që ofron, në afatet e parashikuara nga ligji si edhe riakreditimeve brenda afatit kohor të vlefshmërisë së tyre. Standarti 9 në Politikën e Sigurimit të Cilësisë konsideron monitorimin e vazhdueshëm dhe periodik të programeve për të garantuar se objektivat e programit të studimit dhe kërkesat e studentëve janë prmbushur [Ev: aneks 7.2]. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë e Zbatuar” është liçensuar përmes vendimit të MA nr.1055 datë 29.07.2009. Bazuar për sa më sipër, me vendim të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Bordi i Akreditimit përmes vendimit nr. 49 datë 05.07.2019 ka dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike në këtë insitucion me një afat 3 vjeçar (04.07.2022) [Ev: aneks 1, neni 43, neni 44]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së</p>	<p>KU Logos ndërmerr një politikë gjithpërfshirëse në drejtim të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Hartimi i politikës së sigurimit të cilësisë është në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit 2018-2024 [Ev: aneks 3]. Ndryshimi i politikës për sigurimin e cilësisë përfshin rishikimin, përditësimin e parimeve, standarteve, treguesve, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimin dhe përmirësimin e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit. Politika e</p>

cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

sigurimit të cilësisë është e bazuar në disa parime ku ndër më kryesoret janë:

- a. Student në fokus;
- b. Liderhipi;
- c. Përfshirja e të gjithë palëve të interesuara;
- d. Përmirësimi;
- e. Vendimmarrja e bazuar në evidencë;
- f. Menaxhimi i informacioni;t
- g. Informimi i publikut;
- h. Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi periodik i programeve;

[Ev:aneks 7.2]

Në dokumentin Politika e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë theksohet qëllimin që institucioni i kushton vëmendje cilësisë. Ndër qëllimet me kryesore vlen të përmendet:

- a. Zhvillimi i KU Logos në përputhje me konceptin evropian të cilësisë të arsimit universitar;
- b. Veprimtaritë mësimore, kërkimore, zhvillimore, inovative që nxisin zhvillimin e individëve dhe përgatitjen e tyre dhe bashkëpunim me studentët në një mjedis të lirë akademik;
- c. Përgatitjen e të diplomuarve që mund të kenë akses në tregun kombetar dhe ndërkombetar të punës dhe mund të punojnëme zbulimet më të fundit të shkencës, të ruajnë, shpërndajnë dhe të zhvillojnë rezultatet ekzistuese të arritura në fushat e shkencës, teknologjisë, kulturës dhe shoqërisë;
- d. Ofrimit të programeve cilësore të studimit;
- e. Përmbushjes së standarteve të cilësisë;

[Ev:aneks 7.2]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Veprimtaria për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga politika për sigurimin e cilësisë e cila hartohet nga Komisioni i Përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë [Ev: aneks 7.1, aneks 7.2]. Përgjegjësitë e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë janë shprehur qartë në nenin 11 të Rregullores së Sigurimit të Cilësisë [Ev: aneks 7.1].</p> <p>Për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve KU Logos ka ngritur Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila kryen funksionin e saj bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë [Ev: aneks 7.1].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>NJSBC është njësi integrale e cila vepron në nivel institucional dhe përgjegjëse për garantimin e cilësisë në KU Logos. Baza e zhvillimit të punës së saj është monitorimi i cilësisë së mësimdhënies [takim në institucion]. Kjo njësi zhvillon veprimtarinë përmes zbatimit të procedurave në vlerësimin e programit të studimit, stafit akademik dhe veprimtarisë që zhvillon Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës. Veprimtaria e NJSBC është gjithëpërfshirëse dhe rezultatet e saj shprehen në raporte vjetore, të cilat diskutohen edhe në nivel njësi bazë dhe përkthehen në plan veprimi [Ev: aneks 25.1, aneks 48.1]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë në bashkëpunim me NJSBC-se për vjeljen e informacionit mbi ecurinë e programit dhe performancën e personelit etj. përdor një numër vlerësimesh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin e lëndës nga studenti (pyetësor që plotësohet përpara provimit); - Vlerësim për stafin akademik nga studentët; - Vlerësim të përgjegjësit të njësisë bazë për stafin akademik; - Vetvlerësim të stafit akademik; - Vlerësim për stafin administrativ; - Vlerësim për platformën online gjatë covid – 19; <p>[Ev: aneks 7.5; aneks 28.1.1; aneks 28.1.2; aneks 28.1.3; aneks 28.1.4; aneks 28.1.5; aneks 28.1.6]</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimet që institucioni ndërmerr në kuadër të përmbytjes së programit të studimit, mësimdhënies, performancës së stafit akademik dhe administrativ përpunohen dhe shprehen në raporte vjetore. Rezultatet e vlerësimeve janë përdorur si burim për përmirësimin e cilësisë dhe vlerësimit. Në raportin vjetor si problematikë theksohet situata që paraqitet në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar dhe cilësia në hyrje e</p>

	cila është përmiresuar disi për shkak të vendosjes së mesatares së pranimit për pranimin në programin bachelor [Ev: aneks 25.2].			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit përfshijnë evidenca në lidhje me vlerësimet e bëra për programin e studimit dhe stafin akademik. Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës diskuton problematikat e dala nga të dhënat e mbledhura dhe shoqëron një plan masash për përmirësim [Ev: aneks 25.2]. Konkretisht GVJ u njoh për vitin 2021 për programin e studimit Bachelor në “Informatikë e Zbatuar” ku një student ka kërkuar të përfshijë dhe projekte reale në mësimdhënie dhe ndjekja e saj nga ana e Departamentit të Informatikës së Zbatuar & Statistikës [Ev: aneks 25.2; aneks 25.3; aneks 25.1; aneks 25.4].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë ndërmer në mënyrë periodike sondazhe në lidhje me vlerësimin e programit mësimor dhe performancës e të gjithë grupeve të interesit të përfshirë në procesin mesimor [takim në institucion]. Në fund të çdo semestri NJSBC organizon: <ul style="list-style-type: none"> a. Formularë vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e pedagogut [Ev: aneks 7.5]. Në këtë drejtim studenti jep mendimin e tij në lidhje me qëllimin dhe përmbajtjen e lëndës dhe mënyra e komunikimit të saj tek studenti, metodologjia e mësimdhënies, optimizimi dhe drejtimi i mësimit; b. Formularë vlerësimi nga studenti për veprimtarinë e departamentit. Përmes këtij formulari studenti ka mundësi të japë mendimin e tij në lidhje me punën që departamenti ka bërë në drejtim të vënies në dispozicion të planit mësimor, të programeve mësimore të lëndëve, informimi në lidhje me çështjet e mësimi, veprimtaria mbështetëse kërkimore

shkencore të studentëve, tërheqja e mendimit të studentëve në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies, përmirësimin e praktikës profesionale, literatura etj.

NJSBC organizon në fund të çdo viti:

- a. sondazhe në lidhje me performancë e stafit administrativ. Për këtë një formularë vetvlerësimi është hartuar dhe plotësohet nga secili specialist [Ev: aneks 7.5];
- b. Formular vlerësimi për personelin administrativ i cili plotësohet nga Administratori. Në këtë formular jepet mendimi në lidhje veprimtarinë e punës së personelit administrativ, aftësitë e komunikimit, planifikimi, organizimi dhe arritja e rezultateve, analiza e problemeve dhe vendimarrja. Ky formular shoqërohet në fund me dhënien e mendimin në lidhje me rekomandimin për vijimin e punesimit [Ev: aneks 7.5].
- c. Performanca e stafit akademik vlerësohet edhe përmes plotësimit të tre formularë vëzhgimi nga kolegët. Qëllimi i këtij formulari është zhvillues dhe plotësohet nga kolegu i cili merr pjesë në seancën e vëzhgimit.

Në fillim të procesit nga ana e pedagogut që do të kryejë vëzhgimin plotësohet formulari në lidhje me çështjet bazë si: vlerësohet dhënia e qartë e objektivave të mësimin nga pedagogu i lëndës i cili vëzhgohet, aspektet që kanë nevojë për feedback, komente në lidhje me mësimin e organizuar nga pedagogu.

Në fund të procesit të mësimin plotësohet formulari i dyte i vëzhgimit ku jepet feedback në lidhje me procesin mësimor. Në këtë formular jepet mendimi për mënyrën e organizimit të mësimin, çfarë aspektesh paraqesin nevojë për përmirësim dhe mënyra e arritjes së tyre.

Formulari i 3- të i vëzhgimit konsiston në reflektim dhe diskutim. Në këtë formular diskutohet dhe reflektohet në lidhje me procesin e vëzhgimit për seancën e dëgjuar dhe për mësimdhënien në përgjithësi dhe përmirësimet [Ev: aneks 7.5]

- d. Formular për vlerësimin e veprimtarisë së përgjegjës të njësisë bazë i cili plotësohet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara [Ev:

	<p><i>aneks 7.5]. Në këtë drejtim synohet të vlerësohet performanca e drejtimit të njësisë bazë në aspektet: përgjegjësi administrative, përgjegjësi për personelin akademik, përgjegjësi për kurrikulën dhe përgjegjësi për studentët. Pyetsori në fund shoqërohet edhe me dhënien e mendimit në lidhje me rekomandimin për promovimin në pozicione drejtuese.</i></p> <p>NJSBC përmbledh rezultatet e formularëve të vlerësimit dhe i pasqyron ato në raportet periodike. Të dhënat shërbejnë për proceset e akreditimit institucion dhe të programeve të studimit [Ev: <i>aneks 1- neni 43, neni 44; aneks 3]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit Institucioni zhvillon metoda dhe forma të cilat variojnë në funksion të qëllimit dhe objektivave që ka çdo strukturë e ngritur. NJSBC në këtë drejtim zhvillon pyetsorë në lidhje me:</p> <ol style="list-style-type: none"> Zhvillimin e provimeve dhe raportimin e temave mësimore; Zhvillimin e pyetsorëve në lidhje me përthithjen e mendimit të studentëve për përmirësimin e syllabuseve; Plotësimin e regjistrave; <p>Në përshtatje edhe me kushtet për periudhën e shkaktuar nga covid-19, janë hartuar pyetsorë online ku studenti ka patur mundësinë të japë mendimin e tij në lidhje me performancën e stafit akademik dhe në lidhje me platformën dixhitale të ofruar nga institucioni për mësimin online. Në procesin e vlerësimit online përpjekja janë bërë në drejtim të ruajtjes së anonimatit [Ev:<i>aneks 25.3]</i>. Për të ruajtur konfidencialitetin anketimi është zhvilluar në Microsoft Teams (Forms) [Ev; <i>aneks 24.1; aneks 24.2]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin e metodave të drejtpërdrejta në drejtim të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. Konkretisht përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> Formularë vlerësimi në lidhje me performancën e stafit akademik; Formularë vëzhgimi të kolegëve; Formularë të cilët masin cilësinë e punës së sekretarisë mësimore; Formularë vlerësimi online në lidhje me platformën dixhitale të ofruar nga institucioni; <p>Në procesin e vlerësimit merret mendimi i stafit akademik dhe studentëve në lidhje me përmirësimet e nevojshme që</p>

<p>ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>paraqiten në përmbajtjen e lëndëve ose të programit mësimor në tërësi. Kjo thekson edhe njëherë procesin e vlerësimit si një proces gjithëpërfshirës.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e aDIZSnistrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin e metodave të tërthorta në lidhje me vlerësimin dhe garantimin e cilësisë në programin e studimit Bachelor në “Informatikë të Zbatuar. NJSBC në bashkëpunim edhe me zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës përthith mendimin e alumni në lidhje me programin mësimor. Realizimi i praktikës mësimore dhe futja e saj në programin mësimor (2020) ka sjellë edhe avantazhin e përthithjes së mendimit të punëdhënësve në lidhje me përmbajtjen e programit mësimor. Helius System e cila është një kompani që bashkëpunon në mënyrë aktive me departamentin e Informatikës së Zbatuar & Statistikës ka dhënë një impakt pozitiv në këtë drejtim [takim me stafin akademik].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të</p>	<p>KU Logos ka hartuar dy dokumenta të rëndësishëm që janë bazë e veprimtarisë së procesit të sigurimit të cilësisë në këtë institucion: Politika për Sigurimin e Cilësisë dhe Rregullore për Sigurimin e Cilësisë. Bazuar në evidencat e paraqitura nga institucioni dhe takimet e zhvilluara GVJ konstaton se</p>


<p>brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>larmia e formularëve të vlerësimit, raportet periodike që NJSBC ka prodhuar në mënyrë periodike japin qartë procesin gjithpërfshirës të të gjithë palëve në këtë proces [Ev: takime në institucion; aneks 29; aneks 28.1; aneks 28.1.1; aneks 28.1.2; aneks 28.1.3].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>KU Logos ka hartuar edhe dokumentin “Politika për Sigurimin e Cilësisë” [Ev: aneks 7.2]. Në këtë dokument janë theksuar parimet bazë të menaxhimit të cilësisë të cilat në mënyrë indirekte theksojnë përfshirjen e të gjithë grupeve të interesit në këtë proces. Në dokumentin “Rregullore për Sigurimin e Cilësisë” janë theksuar fushat e vlerësimit të brendshëm ku përmendim: veprimtaria tërësore e institucionit, programet e studimit, mësimdhënia, kërkimi shkencor, arritja e studentëve, shërbimet ndaj studentëve, performanca personelit akademik dhe menaxhimi i institucionit. GVJ konstaton në këtë dokument dhënien e përgjegjësive të të gjithë palëve në këtë proces si vijon më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati Akademik – neni 8; • Komisioni i Sigurimit të Cilësisë – neni 11; • Rektori i KU Logos – neni 12; • Administratori i KU Logos – neni 15; • Grupi i vlerësimit të brendshëm për akreditim institucional – neni 17; • Drejtuesi i njësisë bazë – neni 20 • Grupi i vlerësimit të brendshëm për akreditim program studimi – neni 21; • Studentët; • Stafi akademik; <p>Procesi i vlerësimit monitorohet nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe NJSBC [takim në institucion; aneks 7.1; aneks 7.2].</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Informatikë e Zbatuar” janë përfshirë staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe student. NJSBC ndërmer në mënyrë periodike sondazhe në lidhje me vlerësimin e programit mësimor dhe performancës e të gjithë grupeve të interesit të përfshirë në procesin mësimor [takim në institucion].</p> <p>Gvj konstaton përfshirjen e njësisë bazë në këtë proces. Përmendim këtu:</p>

studentët e programit të studimit.	<p>c. formularë vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e pedagogut [Ev: aneks 7.5].</p> <p>d. Formularë vlerësimi nga studenti për veprimtarinë e departamentit.</p> <p>e. Performanca e stafit akademik vlerësuar nga kolegët;</p> <p>f. Formular për vlerësimin e veprimtarisë së përgjegjësit të njësisë bazë [Ev: aneks 7.5].</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Procedurat e vlerësimit në kuadër të sigurimit të cilësisë organizohen nga institucioni pa cënuar integritetin dhe lirinë e çdo individi të përfshirë në këtë proces. GVJ konstaton “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale” të hartuar nga Komisioni për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të dhënave personale (Vendim nr. 03 datë 14.02.2020) si dokument i rëndësishëm i cili garanton shmangien e çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie.</p> <p>GVJ konstaton në komunikimet e paraqitura si evidenca nga Institucioni një transparencë të procesit të vlerësimit dhe një përkushtim në ruajtjen e anonimatit [Ev: aneks 7.4; aneks 7.5; aneks 36.2].</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ konkludon se përthithja e mendimit të ekspertëve të jashtëm është konsideruar e rëndësishëm në përmirësimin e programeve mësimore.</p> <p>Në këtë drejtim gjejmë evidenca dhe shembuj nga takimet në institucion si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rekomandimet e dhëna nga eksperte të jashtëm në kuadër të akreditimit institucional; 2. Rekomandime të dhëna nga ekspertët e jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit; 3. Rekomandime të dhëna nga studentët dhe alumni i cili ka sjellë edhe përfshirjen e praktikës profesionale në programin mësimor; 4. Rekomandime të dhëna nga auditimi i jashtëm financiar në lidhje me cilësinë e investimeve; [Takim në institucion] 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton se hartimi i politikave të sigurimit të cilësisë në KU Logos janë transparente dhe ku secili ka dhënë lirshëm mendimin e tij. Në dokumentin “Politika për Sigurimin e Cilësisë” kreu IX thekson komunikimin dhe publikimin e rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit. KU Logos dhe njësia bazë (Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës) janë përgjegjëse për komunikimin dhe publikimin e rezultateve të procesit të vlerësimit. GVJ konstaton përmes dokumenteve një transparencë në mbledhje departamenti në lidhje me diskutimet për rezultatet e procesit të vlerësimeve dhe marrjen e planit të masave në drejtim të përmirësimeve të kërkuara [Ev: aneks 7.4; aneks 7.5]. Të dhënat publikohen edhe në website në lidhje me rezultatet për akreditim e jashtëm institucional (http://www.kulogos.edu.al/al/external-evaluation.html).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>KU Logos publikon dhe bën transparente të gjithë rezultatet e vlerësimit të programit të studimit. Rezultatet e vlerësimit të brendshëm bëhen transparente në të gjithë hallkat dhe janë subjekt diskutimi dhe plan masash për përmirësim. Në lidhje me dokumentat e rëndësishëm në website një rubrikë e veçantë “Sigurimi i Cilësisë” ofron informacion në lidhje me vlerësimet në kuadër të akreditimit institucional (http://www.kulogos.edu.al/al/external-evaluation.html), dokumentat e rëndësishëm si Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, Kodi i Cilësisë në IAL-të, Politika për Sigurimin e Cilësisë në gjuhën shqipe dhe në anglisht [Ev: aneks 7.1; aneks 7.2; aneks 7.3].</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e përfuara shoqërohen edhe me një plan masash përmirësimi. GVJ konstaton evidencë nga institucioni në lidhje me diskutimet e zhvilluara në Departamentin e Informatikës e Zbatuar & Statistikës në këtë drejtim dhe përmirësimet e rekomanduara. Raportet vjetore japin edhe një pasqyrim të punës së zhvilluar me studentët, dhe përmirësimet e arritura në këtë drejtim [Ev: aneks 7.4; aneks 7.5]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të</p>	<p>Proceset e vlerësimit janë periodike në çdo semester/ vit. NJSBC ndërmer me korrektësi monitorimin dhe vlerësimin përmes përpunimit statistikor të të dhënave dhe hartimit të raporteve vjetore të cilat diskutohen në strukturat përgjegjës</p>

monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	dhe shoqërohen me rekomandimet e duhura për përmirësim [takim në institucion]			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	KU Logos organizon takime informimi për studentët e vitit të parë në lidhje me rëndësinë e anketimeve në kuadër të matjes së cilësisë. Java e Orientimit e organizuar nga Institucioni ka shërbyer si orientuese dhe informuese për studentët në lidhje me përgjegjësitë që ata kanë në procesin e vlerësimit, pjesëmarrjen në anketime dhe përmbushjen me përgjegjshmëri nga ana e tyre. Staf i akademik zhvillon punë informuese gjatë semestrit dhe tutoriati jep një ndihmë në këtë drejtim [Ev: takim në institucion; aneks 25.1; aneks 25.2; aneks 25.3; aneks 25.4]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë e Zbatuar”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Staf i KU “Logos” (PAE dhe PAK) është me eksperiencë dhe i mirëkualifikuar për lëndët e përfshira në programin e studimit;
2. Programi i studimit mbulon konceptet themelore, teorinë dhe aftësitë praktike në fushën e programit të studimit “Informatikë e Zbatuar”;
3. KU “Logos” i ofron studentëve dhe stafit mundësi për internship, mobilitete apo programe të tjera kërkimore;
4. KU “Logos” ka lidhur marrëveshje të ndryshme me aktorë të rëndësishëm të tregut, industrisë, institucione të ndryshme arsimore vendase dhe të huaja;
5. Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës është i përkushtuar në përmirësimin e mëtejshëm të inovacionit, kërkimit, trendeve të fundit dhe praktikave më të mira;

6. Politikat dhe procedurat e ndjekura nga KU "Logos" janë të mirëpërcaktuara duke garantuar barazinë tek çdo student në programin e studimit "Informatikë e Zbatuar";
7. Kolegji Universitar "Logos" ofron nje program studimi i cili perputhet me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës;
8. Institucioni ofron një bazë të pasur laboratorike duke aftësuar studentët në drejtim të praktikës;
9. Institucioni garanton lirinë dhe të drejtën e shprehjes së mendimit kritik të studentëve;
10. Kolegji Universitar "Logos" ofron një mjedis i cili garanton cilësinë në mësimdhënie. Institucioni ofron një infrastrukturë të duhur për zhvillimin cilësor të mësimdhënies dhe në përmbushje të standarteve në fuqi;
11. Departamenti i Informatikës së Zbatuar & Statistikës i kushton një vëmendje të veçantë rekrutimit dhe kualifikimit të stafit akademik;
12. Institucioni zhvillon punë serioze në vijim të pasurimit të fondit të bibliotekës;
13. Institucioni siguron informim të vazhdueshem të studentëve gjatë ciklit të plotë të studimeve;
14. KU Logos zbaton një politikë gjithpërfshirëse në drejtim të sigurimit të brendshëm të cilësisë;

b. Pika të dobta:

1. Programi i studimit duhet të rishohë vendosjen e kërkimit shkencor më në qendër të prioritetëve të veta në kurrikulën e tij, në kuadër të zhvillimit të aftësive dhe kompetencave të avancuara për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme; *[Standarti II.1, Kriteri 4]*
2. Literatura e lëndëve të programit të studimit, e deklaruar në syllabuset e tyre, rezulton në një përqindje të më tepër se 5 vite; *[Standarti II.4, Kriteri 6]*
3. Numri i stafit akademik efektiv është në kufirin minimal të kërkesës së shprehur në kornizën ligjore; *[Standarti IV.2, Kriteri 4]*

Rekomandime:

1. GVJ sugjeron realizimin e një studimi tregu të vazhdueshëm në lidhje me përditësimin e teknologjive, kërkesave dhe pritshmërive të punonjësve të studentëve të programit të studimit;
2. GVJ sugjeron një rishikim të renditjes dhe përmbajtjes së disa prej lëndëve të ofruara në programin e studimit;
3. GVJ konstaton që literatura bazë dhe e rekomanduar në një pjesë të lëndëve është më e vjetër se 5 vjet dhe sugjeron përditësimin e tyre;
4. GVJ sugjeron që IAL të realizojë më tepër marrëveshje me kompanitë që mundësojnë praktikatat profesionale të studentëve të programit të studimit;
5. GVJ sugjeron rritjen e stafit akademik efektiv e cila do të sjelle lehtësimin e punës shkencore të stafit në drejtim të plotësimit të objektivit të tyre me grada shkencore dhe forcimin e kapaciteteve për përmbushjen e objektivave aftgjatë të njësisë baze;


6. GVJ konstaton mungesë të vendosjes së kriterëve të pranimit në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Informatike e Zbatuar". GVJ sugjeron përfshirjen e "kriterëve të pranimit" si një nen ligjor i veçantë në këto rregullore;
7. GVJ sugjeron një rishikim të formatit të procesverbalit ku të pasqyrohen qartë edhe vlerësimi me pikë të studentit gjatë vitit dhe rezultatin e tij në provimin përfundimtar. Ky rishikim do të sjellë një rritje të transparences dhe një lehtësim të punës së sekretarisë në lidhje me informimin ndaj studentëve;
8. GVJ sugjeron që analiza vjetore e njësive bazë duhet të shoqërohet edhe me pasqyrimin e problematikës dhe hapat konkrete për përmirësimin e tyre;

Conclusions of the evaluation of the first cycle program Bachelor in "Applied Informatic"

a. Strengths and affirmations:

1. Experienced and knowledgeable full time and part time faculty members with advanced degrees in their fields;
2. Curriculum covers key concepts, theories, and practical skills in the field;
3. Opportunities for hands-on learning, internships, or mobilities and exchange;
4. Diverse partnerships with industry leaders, organizations, or community groups;
5. Commitment to innovation, continuous improvement, and staying current with industry trends and best practices;
6. The policies and procedures followed by KU "Logos" are well defined, guaranteeing equality for every student in the "Applied Informatics" study program;
7. "Logos" University College offers a study program that is in line with the needs and demands of the labor market;
8. The institution offers a rich laboratory base, enabling students in a practical direction;
9. The institution guarantees the freedom and expression of students critical thinking;
10. "Logos" University College provides an environment that guarantees quality in teaching. The institution offers an appropriate infrastructure for the qualitative development of teaching and in compliance with standards in force;
11. The Department of Applied Informatics & Statistics pays special attention to the recruitment and qualification of academic staff;
12. The institution develops a continuous serious work in the enrichment of the library fund;
13. The institution provides continuous information to students during the full cycle of studies;
14. KU Logos implements a comprehensive policy in terms of internal quality assurance;



b. Weaknesses:



1. The study program does not include scientific research at the core of their curriculum, as it is essential in the development of advanced competences and skills for complex problem solving; [*Standart II.1, Criteria 4*]
2. Not all subjects have an updated literature (basic and recommended) in their syllabi, and in a specific number of cases is older than 5 years; [*Standart II.4, Criteria 6*]
3. The number of effective academic staff is in the minimum limit of the requirements stated in the legal framework; [*Standart IV.2, Criteria 4*]

Recommendations

1. EVG suggests the HEI to conclude a periodic market study for the continuous update of their curriculum for the inclusion of new technologies, and as expected by the industry;
2. EVG recommends that the department reconsiders and reevaluates the declared literatures in their course syllabi and renews them;
3. EVG finds that the basic and recommended literature in some subjects is older than 5 years and suggests updating them;
4. EVG suggests the institution to accord more partnerships and agreements with companies that are willing to accept their students internships;
5. EVG suggests increasing the number of effective academic staff which will facilitate the scientific work of the staff in terms of fulfilling their objective with scientific degrees and strengthening the capacities for fulfilling the long-term objectives of the base unit;
6. EVG find a lack of setting admission criteria in the Regulations of the Bachelor Study Program in "Applied Informatics". GVJ suggests the inclusion of "admission criteria" as a separate legal article in these regulations;
7. EVG suggests a review of the format of the minutes, where the student's evaluation with points during the year and his result in the final exam are clearly reflected. This review will bring an increase in transparency and an easing of the work of the secretariat in relation to informing students;
8. EVG suggests that the annual analysis report of the department should also be accompanied by the reflection of the problems and the concrete steps for their improvement;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X